Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Republika e Kosovës / Kuvendi Komunal/Assembly of Municipality, Skenderaj
Nr. 01-060/01-0007270/25
Data 20.02.2025

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

## *THËRRET*

**Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj**, e cila do të mbahet me datë **27.02.2025**, (ditë e enjte), me fillim prej orën **10:00**, në Sallën e Kuvendit

**Mbledhja do të ketë këtë:**
**REND DITE**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës i ekzekutivit për vitin 2024, me Nr.02-052/01-0007264/25, të datës 20.02.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
5. Propozim-vendim për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko-Natyra", Sh.A.Skenderaj, me Nr.02-404/02-0007012/25, të datës 21.02.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
6. Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, Janar - Dhjetor 2024, me Nr.08-400/01-0006875/25, të datës 18.02.2025, (Raporton drejtori i DSHMS-së, **z.Shahin Tahiri**),
7. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Republika e Kosovës / Komuna e Skenderajt / Kuvendi i Komunës

**KRYESUESJA E KUVENDIT**
znj. Adelina Spahiu

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr. 01-060/01-0007270/25
Data 26.02.2025

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

**Kuvendi i Komunës**/SkupštinaOpštine/MunicipalityofAssembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës **30.01.2025**, ora **10:00**

**Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, me Nr. 02-052/01-0002664/25, i datës 17.01.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
   **Pika shtesë;**
5. Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtarit z. Osman Smajli, me anëtarin e kuvendit z.Azem Gashi, si dhe dhënia e betimit, (Raporton Kryesuesja e kuvendit, znj.**Adelina Spahiu**);
6. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

**Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:** Të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 27 anëtar, mungojnë me arsye Arjeta Rama, Alketa Mecini, Ferdane Beqiri-Emini dhe Afrim Kabashi.
Para miratimit të rendit ditës e kemi një pikë shtesë:
-Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtarit z. Osman Smajli, me anëtarin e kuvendit z. Azem Gashi, si dhe dhënia e betimit;
Shkojmë në votim për futjen në rend dite: Konstatojmë me (27) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtarit z. Osman Smajli, me anëtarin e kuvendit z. Azem Gashi, si dhe dhënia e betimit.
Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;
**Hysni Mehani-VV:** Fjala përshëndetëse, Kërkoj që për ketë rend dite të futet si pikë shtesë një lloje Informate nga ana e kryetarit të komunës në lidhje me drejtorin e dënuar për korrupsion në Leposaviq, Haxhi Bejta në vitin 2015-2017, që tash e kemi një vendim që ky drejtor është dënuar për korrupsion e kurdisje tenderësh në Leposaviq e atë në gjuhen serbe, i njëjti vazhdon me qenë tash drejtor i prokurimit në Skenderaj. Është e nevojshme që na si këshilltar komunal, po edhe si qytetar me ditë së kush e ka qua këtë drejtor në atë kohe në Leposaviq me kurdise tender serbisht, kush e ka mbajte atëherë, kush po e mban tash, pse nuk po e shkarkoni një njeri që ka kurdis tender serbisht në Leposaviq e që është i dënuar për korrupsion për çështjet e prokurimit, me vazhdua me qenë drejtor i prokurimit e mos me shkarkua, edhe mos me ja dhënë as një sqarim as asamblesë as qytetarit është e papranueshme edhe po kërkoj me u futë si pikë shtesë një:
Informatë lidhur me drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, nga ana e kryetarit?
**Kryesuesja**, Dikush tjetër, Kryetari nuk gjendet këtu, e ka një agjendë në Prishtinë dhe nuk mundem me dhënë informata tutje, Shkojmë në votim për futje në rend dite propozimin e Hysni Mehanit, Informatë lidhur me drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, nga ana e kryetarit;

Konstatojmë me (10) vota për, (16) kundër dhe (1) abstenim, nuk futet në rend dite Propozimi i Hysni Mehanit, Informatë lidhur me drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, nga ana e kryetarit.
Vazhdojmë më miratimin e rendit ditës me piken shtesë,
Konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi ditës, me piken shtesë.
Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,
-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim;
Konstatojmë me (24) vota për, (0) kundër dhe (3) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;
-Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, me Nr. 02-052/01-0002664/25, i datës 17.01.2025, (Raporton);
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Fjala përshëndetëse, me kohe e keni pas Raportin financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, sipas kërkesave ligjore është përgatite gjitha pikat në detaje janë të përfshira, gjitha lëvizjet buxhetore që kanë ndodhur gjatë vitit 2024, duke filluar nga buxheti fillestar që e kemi pas të aprovuara në kuvend komunal, 18,582.310.00€, ndërsa lëvizjet gjatë vitit 2024, shtesë edhe për 2,722.113.00€ kanë rrjedh nga grandi i përgjithshëm 1,186.644.00€, pastaj pjesa e bartjes të hyrave vetanake nga viti 2023 të pa shpenzuara 340 mijë€, dhe nga grandi i performances që e kemi përfitua 603,119.00€, për të pas një buxhet për shpenzim deri në fund të vitit 2024, në vlerë prej 21,304.423.13€. Të hyrat vetanake janë realizua në 93.55%, gjitha mjetet e pa shpenzuara nga tre mujori paraprak janë bartur në tre mujorin në vijim sipas procedurave ligjore. Me vendime gjyqësore përmbarimore të emër të shtesave shujtave licencimit dhe inflacionit janë shpenzuar 2,455.186.46€, të paguara nga kategoritë të ndryshme. Të hyrat vetanake janë realizuara në 93.55%, ose 1,762.696.00€, Buxheti i shpenzuar 20,952.941.40€, 55.93%, Paga dhe shtesa, 11.91% Mallra dhe shërbime, 1.45% Shërbime komunale, 5.24%, subvencione dhe 25.47% Investime kapitale. Në faqen 9 janë shpenzimet sipas kodeve dhe nën kodeve, në faqen 11 është lista e projekteve kapitale që janë shpenzuar 5,337.593.84€ ose 95.73%, sipas planit në realizimin e projekteve janë shpenzuar 4,575.785.13€, me vendime gjyqësore përmbarimore në kategorinë e projekteve kapitale janë marrë 761,808.71€ ose 13.44%. Pjesa e fundit, është shpenzimi i buxhetit neper të gjitha kategoritë sipas të gjitha drejtorive, dhe i kemi obligime të pa paguara për vitin 2024, në total 332,893.93€, në Mallra dhe shërbime janë 124,562.97€, Shërbime komunali 10,984.00€, Subvencione transfere 48,600.00€, dhe Investime kapitale 148,746.93€. Të hyrat komunale që priten për bartje mbesin të pa shpenzuara vitin 2024 do të jenë rreth 235,100.00€ së bashku me gjobat e gjykatave të cilat deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk kemi pas evidencë të saktë. Ndërsa të pa shpenzuara nga grandi qeveritar kanë mbetur 84,053.00€ në projektet kapitale, kjo ishte në pika të shkurta sa i përket këtij raporti.
**Kryesuesja:** Lista VV, dhe Lista Ideal, e lëshojnë sallën, e hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim, Konstatojmë me (17) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, përkrahet, Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, Nr.02-052/01-0002664/25, i dt. 17.01.2025.
Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës;
-Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtarit z.Osman Smajli, me anëtarin e kuvendit z.Azem Gashi, e ftoj Azem Gashin ta lexoj betimin, ja kaloj fjalën:
**Azem Gashi-IDEAL:** Unë, (*Azem Gashi*) "betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mija si anëtar i Kuvendit të Komunës së Skenderajt, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

**Kryesuesja:** Shkojmë në votim, Konstatojmë me (24) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet. Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtarit z.Osman Smajli, me anëtarin e kuvendit z.Azem Gashi, Urime Azem,
Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës,
Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, kërkoj nga sekretaria që këto pyetje mos të kalojnë në seancën tjerët, me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ
Nr.
No. 02-052/01-0007264/25
Data.
Data. 20.02.2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipality

ZYRA E KRYETARIT / KABINET PREDCEDNIKA / OFFICE OF THE MAYOR

# RAPORTI VJETOR I PUNËS I EKZEKUTIVIT

# 2024

## ZYRA E KRYETARIT

Ekzekutivi i Komunës së Skenderajt, në kuadër të zbatimit të planit të punës për vitin 2024, ka realizuar një sërë projektesh kapitale, në interesin e përgjithshëm të komunës dhe qytetarëve, gjithnjë në kuadër të përgjegjësive të veta institucionale e ligjore që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës, ligjet tjera të zbatueshme në vendin tonë dhe aktet tjera që adresojnë çështjet e nivelit lokal.

Fushat kryesore të Qeverisjes sonë, si zhvillimi ekonomik, ofrimi i shërbimeve, zhvillimi i arsimit, shëndetësia e kultura, janë trajtuar me prioritet të lartë edhe gjatë vitit 2024, nëpërmjet realizimit të projekteve që janë financuar kryesisht nga buxheti i Komunës, nga bashkëfinancimi me donatorë të jashtëm dhe me nivelin qendror.

Dy muaj pasi kishte filluar viti 2024, Komuna e Skenderajt ka nënshkruar marrëveshjen nga granti i përformancës, në vlerën prej 1 milion e 200 mijë euro, si rezultat e përformancës së lartë që u tregua gjatë vitit paraprak (2023). Këto mjete financiare u përdorën për realizimin e projekteve kapitale në interesin e qytetarëve, përkatësisht për instalimin e ndriçimit publik në fshatra, një nga premtimet e Kryetarit të Komunës, Fadil Nura, për asfaltim të rrugëve, projekte për trajtimin e ujërave të zeza dhe projekte të tjera.

Një tjetër nismë e mirë që filloi vitin 2024 ishte edhe fillimi i hartimit të projektit për Pendën e Kuqicës, një projekt dhjetëra milionësh i cili do të zgjidhë problemin e furnizimit me ujë të pijes për më shumë se 200 mijë banorë, dhe përveç kësaj, do të ndihmonte edhe fushën e bujqësisë me ujitje të tokës bujqësore.
Ky projekt mbetet ndër prioritetet kryesore të Qeverisjes Lokale, ndërsa realizimi i tij do të mund të bëhej vetëm me mbështetje të nivelit qendror, për shkak të kostos së lartë financiare dhe të papërballueshme për buxhetin e komunës.

Përveç këtyre, tjera projekte të rëndësisë së madhe janë edhe projekti i Muzeut dhe Bibliotekës së qytetit dhe projekti i Stacionit të Autobusëve, projekte këto të cilat gjithashtu ishin pjesë e listës së premtimeve të kryetarit Nura në vitin 2021.

Ndryshe nga këto veprime, Ekzekutivi i Komunës së Skenderajt, përkatësisht drejtoritë komunale, përfshirë organet vartëse dhe njësitë e veta, ka vazhduar me përkushtim përmbushjen e detyrimeve që dalin nga plani i punës për vitin 2024, i miratuar në Kuvendin Komunal.

Në kuadër të këtij raporti, në mënyrë të detajuar me përshkrim të aktiviteteve dhe aspektin financiar, të gjitha drejtoritë kanë paraqitur në formë të shkruar punën dhe aktivitetet e tyre.

Në kuadër të përgjegjësive dhe autorizimeve ligjore, Kryetari i Komunës, si organi më i lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2024 ka përmbushur edhe planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me akterët relevantë të përfaqësuar në këtë këshill, duke trajtuar çështje që lidhen me fushën e sigurisë publike dhe duke nxjerrë një sërë rekomandimesh dhe adresuar çështje të fushës së përgjegjësisë së KKSB-së.

Ekzekutivi ka arritur synimet dhe përgjegjësitë e veta karshi qytetarëve, me realizimin e kërkesave dhe planit të punës, nëpërmjet qeverisjes së përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse.

Në kuadër të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës, gjatë vitit 2024, Kryetari i Komunës, ka mbajtur 2 takime publike me qytetarë, për të diskutuar aktivitetin dhe punën e ZKA-së për vitin 2024.
Kryetari i Komunës ka mbajtur gjithashtu takime të përjavshme brenda një viti, me qytetarë, aktivitet ky që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

## ZYRA PËR INFORMIM

Ashtu siç është përcaktuar edhe në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat i ka, Zyra për Informim ka vazhduar punën intensive gjatë gjithë vitit 2024 duke informuar qytetarët dhe publikun për aktivitetet e Komunës së Skenderajt në interes të përgjithshëm të qytetarëve, ku përfshihen publikimi i lajmeve ditore në faqen zyrtare të komunës, pastaj publikimi i qindra shpalljeve, konkurseve, njoftimeve, thirrjeve të ndryshme. Janë publikuar planet dhe raportet e punës, projektet e zhvilluara në terren, vendimet, rregulloret, aktet e ndryshme, etj. Poashtu janë publikuar njoftimet nga Zyra e Prokurimit mbi të gjitha aktivitetet e saj, duke publikuar në faqen zyrtare të komunës në internet vazhdimisht kontrata, njoftime për kontrata, njoftime për dhënie të kontratave, njoftime për nënshkrimin e kontratave, njoftimet për anulimin e aktiviteteve të prokurimit, vendimet e OSHP-së, etj. Zyra për informim në faqen e Komunës në rrjetin social Facebook ka publikuar vazhdimisht punë, projekte dhe aktivitete të ndryshme me interes të përgjithshëm për publikun, kurse në platformën qendrore për konsultime publike ka publikuar draft-rregulloret e ndryshme të cilat kanë dalë në konsultim publik.

Gjatë vitit 2024, Zyra për Informim e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit, është marrë me aktivitete të shumta sipas detyrave zyrtare, duke përmbushur qëllimin e saj për informimin e publikut në lidhje me aktivitet e komunës, duke përcjellë nga afër punën e saj. Në veçanti Zyra ka ndjekur nga afër të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal, duke transmetuar live të gjitha seancat e Kuvendit të Komunës si dhe në përfundim të punimeve të seancave ka njoftuar publikun për mbarëvajtjen e tyre dhe vendimet e marra. Janë ndjekur edhe të gjitha takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe poashtu edhe për to ka pas njoftime për publikun. Poashtu janë ndjekur edhe takimet e Komitetit për Komunitete.

Zyra për Informim gjatë gjithë vitit 2024 ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Kabinetin e Kryetarit të Komunës, duke përcjellë nga afër punën dhe aktivitetet ditore të Kryetarit të Komunës. Zyra vazhdimisht ka ndjekur punët dhe aktivitetet në terren dhe aktivitetet në interes për publikun të cilat i ka zhvilluar Kryetari i Komunës, duke e njoftuar publikun për to. Zyra ka ndjekur 6 takime të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhjetëra takime të Bordit të Drejtorëve, 2 takimet e Kryetarit të Komunës me publikun, diskutimet publike në lidhje me draft-rregulloret komunale dhe planet e ndryshme, të gjitha diskutimet për buxhetin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026 si dhe aktivitete të tjera të shumta të cilat janë zhvilluar në kuadër të drejtorive komunale.

Zyra për Informim ka bashkëpunuar ngushtë edhe me media dhe me OJQ në lidhje me çështje për të cilat ato janë interesuar, që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve të komunës duke qenë në dispozicion të tyre për informata të ndryshme për Komunën e Skenderajt. Zyra për Informim ka qenë e përgjegjshme edhe ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike që gjatë vitit 2024 kanë qenë 54, duke u përgjigjur të gjithave brenda afateve ligjore dhe duke dërguar të dhëna tek parashtruesit e kërkesave ashtu siç parashihet me ligj.

Megjithatë, gjatë vitit 2024, Zyra e Informimit është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar në punën e përditshme dhe efikasitetin e shpërndarjes së informacionit. Një ndër problemet më të mëdha edhe gjatë vitit 2024 ashtu sikurse në të kaluarën ka qenë mosfunksionimi i rregullt i ueb-faqes zyrtare të komunës, e cila ka qenë jashtë funksionit për periudha të gjata kohore. Kjo ka penguar publikimin e njoftimeve zyrtare, dokumenteve të rëndësishme dhe informacioneve të tjera të nevojshme për qytetarët, duke detyruar stafin të përdorë kanale alternative për komunikim, si rrjetet sociale dhe mediat tradicionale. Këto probleme kanë shkaktuar edhe angazhim dhe presion të shtuar tek zyrtarët e Zyrës për Informim, duke punuar edhe gjatë orëve të mbrëmjes me qëllim të vetëm publikimin e të dhënave në faqen e komunës. Në shumë raste, si alternativë janë përdorur rrjetet sociale dhe tabela e shpalljeve.

Zyra për Informim ka qenë e hapur dhe transparente ndaj qytetarëve të shumtë në lidhje me pyetje, kërkesa apo informata të cilat janë ngritur nga ana e tyre dhe për të cilat është ofruar përgjigje dhe udhëzime për të vepruar tutje.

## NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore duke pasur për qëllim që të ofrojë shërbime të mira, cilësore, transparente, efikase dhe efektive gjithnjë duke respektuar legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Shërbimit Civil dhe duke synuar që t'i avancojmë shërbimet që ofrohen në këtë sektor, prezanton :

NJMBNJ është bashkëpunimi dhe krijimi i marrëdhënieve të ngushta me Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Financave, Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Agjencitë e linjës si dhe institucionet tjera në nivel lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës në fushën e Burimeve Njerëzore me qëllim të krijimit të kushteve për modernizimin e të dhënave nga këto fusha, mirëmbajtjen e regjistrave të nëpunësve civilë dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase, të shpejta dhe cilësore duke u mbështetur gjithnjë në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

Gjatë vitit 2024 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kryer këto detyra Administrimi i nëpunësve civilë dhe administrimi i të dhënave për nëpunësit civilë.
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar procedurat për pranimin në punë për zyrtaret/ët publik në përputhje me përcaktimet e këtij ligji të QKMF-së në Komunën e Skenderajt.
Respektimi i afateve ligjore në trajtimin e kërkesave dhe nxjerrja e vendimeve në përputhje me ligjet dhe afatet e parapara ligjore në fuqi ndaj këtyre kërkesave;
Funksionalizimi dhe integrimi i sistemit të SIMBNJ-së-Lista e pagave për nëpunësit civilë.
Themelimi i sistemit të administrimit të nëpunësve civilë në bazë të SIMBNJ-së;
Mirëmbajtja e evidencës së akteve juridike.
Përgjigje në Intranet në kërkesat drejtuar NJMBNJ.
Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të shpejta duke respektuar legjislacionin në fuqi;
Implementimi i programeve elektronike të avancuara të cilat kanë mbështetje në ligjet e aplikueshme dhe të ofruara nga Ministria e Administratës Publike.
Si dhe shqyrtimin e lëndëve në total 400 të procesuara përmes intranetit.
Të gjitha kërkesat për pushime janë të gjeneruara përmes sistemit SIMBNJ,
klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës;
identifikon dhe vlerëson, në koordinim me udhëheqësen/in e njësisë në mënyrë periodike, nevojat për trajnim të nëpunëseve/ëve civilë të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve për zhvillimit profesional;
menaxhon proceset e ndërlidhura me emërimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, transferimit, suspendimit, pensionimit dhe çdo proces tjetër që ndërlidhet me punësimin e zyrtareve/ëve publikë;
mbështet procedurën për vlerësimin e performancës, rekomandon transferimin e nëpunëses/it civil, si dhe menaxhon paraqitjen në punë të zyrtares/it publik;. administron planet dhe dosjet individuale përmes SIMBNj-së;
kryen çdo detyrë tjetër të dhënë me ligj.

Gjatë vitit 2024 NJMBNJ në tabelë janë të cekura pensionimet, pushimet pa pagesë, punëtorë të rinj, largimet etj

## ZYRA LIGJORE

Në periudhën Janar - Dhjetor 2024, Sektori Ligjor në Komunën e Skenderajt ka arritur këto objektiva:

| | |
|---|---|
| Vendime për Kryetarin | 681 |
| Autorizime | 11 |
| Kërkesa | 12 |
| Konkluzione | 36 |
| Propozime për Kuvend | 27 |
| Marrëveshje/Kontrata | 17 |
| Konsultime | Permanente |
| Përgjigje në kërkesa | 26 |
| Njoftime | 7 |
| Vërtetime | 4 |
| Rekomandime | 1 |
| Puna në Komisione | 9 |
| Shkresa tjera | 5 |
| **Totali i akteve dhe shkresave të hartuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024 nga Sektori Ligjor është:** | **836** |

## DREJTORIA ADMINISTRATËS

Drejtoria për Administratë në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive ligjore ka hartuar raportin vjetor për vitin 2024, i cili pasqyron punën një vjeçare të kësaj drejtorie në përpjekje për të përmbushur detyrimet dhe obligimet tona në raport me qytetarët dhe komunitetin e biznesit gjithashtu edhe në raport me ministritë e linjës. Objektivi i kësaj drejtorie për vitin 2024 ishte avancimi i shërbimeve tona, përdorimi i sistemeve elektronike për shërbime, njëkohësisht këto shërbime të jenë transparente, cilësore dhe të shpejta për të gjithë qytetarët.

Në vazhdim paraqesim raportin e sektorëve, njësive, zyrave dhe shërbimeve në Drejtorinë e Administratës:

- **SEKTORI I GJENDJES CIVILE**

Sektori i Gjendjes Civile në Skenderaj, ka punuar sipas planit të punës për vitin 2024, ligjit për Gjendjen civile dhe udhëzimeve administrative nga MPB-ja dhe ARC-ja. Është bërë përdorimi i sistemit elektronik të gjendjes civile dhe intranetit nga zyrtarët

e Gjendjes Civile si në zyrën qendrore në Skenderaj, po ashtu edhe në zyrat e vendit në teren. Në këtë shërbim janë kryer të gjitha punët e administrimit të dokumenteve (kërkesave/ parashtresave dhe akteve tjera) siç janë: pranimi i kërkesave, regjistrimi i kërkesave, udhëzime të qytetarëve, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile, regjistrimi lindjeve, vdekjeve dhe martesave si dhe dokumenteve tjera shtesë qe i përkasin këtij sektori. Sektori i gjendjes civile në Komunën e Skenderajt, me hapësirën që ka në zyrën qendrore në Skenderaj së bashku me 6 (gjashtë) zyrat e vendit në teren ka kryer detyrat e punës në maksimum për të arritur objektivat e tyre në përputhshmëri më ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret në fuqi, Zyra Qendrore në Skenderaj ka funksionuar dhe ka bashkëpunuar me të gjitha zyrat e vendit në teren, me konsullatat e Republikës së Kosovës jashtë vendit dhe Agjencionin e Regjistrimit Civil në Prishtinë. Është bërë bartja e zyrës së gjendjes civile në Runik nga objekti i vjetër në të riun, ku objekti i vjetër s'i ka plotësuar kushtet elementare për punë po ashtu e papërshtatshme për shërbim të qytetarëve.

Numri i dokumenteve personale që janë shërbyer vetë qytetarët nga **E-Kioska** sipas sistemit elektronik të gjendjes civile për vitin 2024 është **376.** Në vijim kemi edhe raportin e lëshimit të dokumenteve të gjendjes civile të radhitura sipas sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme- ARC-së.

**DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË BRENI**

| # | Komuna | Certifikatë e lindjes | Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile | Certifikatë e shtetësisë | Certifikatë e martesës | Certifikatë e vdekjes | Certifikatë e vendbanimit | Certifikatë e gjendjes martesore | Deklarat e bashkësis familjar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Skenderaj | 1249 | 15216 | 73 | 2938 | 1572 | 1269 | 1055 | 4117 |
| | **TOTALI** | **1249** | **15216** | **73** | **2938** | **1572** | **1269** | **1055** | **4117** |

**DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË JASHT**

| # | Komuna | Certifikatë e lindjes | Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile | Certifikatë e shtetësisë | Certifikatë e martesës | Certifikatë e vdekjes | Certifikatë e vendbanimit | Certifikatë e gjendjes martesore | Deklarat e bashkësis familjar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Skenderaj | 9344 | 3124 | 227 | 3410 | 376 | 1412 | 496 | 1140 |
| | **TOTALI** | **9344** | **3124** | **227** | **3410** | **376** | **1412** | **496** | **1140** |

- **Sektori i Administrimit me dokumente - QSHQK-së/arkivi**

Sektori i Administrimit me dokumente - QSHQK-së/arkivi, ka bërë pranimin e kërkesave, regjistrimin e kërkesave, udhëzime të qytetarëve, dhe ka proceduar për trajtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në njësitë organizative të komunës.
Përdorimi i dy sistemeve elektronike, Intraneti dhe SMAED, që kanë të bëjnë me sistemin e menaxhimit të dokumenteve në komunë.

Është bërë pranimi i dokumenteve, pranimi i postës, evidentimi dhe bashkimi i shkresave, vulosja e shkresave dhe lëndëve, skanimi i dokumenteve dhe bashkëngjitja e tyre lëndëve, dërgimi i akteve dhe lëndëve në procedim, dërgimi i postës, shpërndarja e postës dhe e lëndëve, duke përfshirë edhe postën elektronike, arkivimin e lëndëve të njësive organizative të komunës dhe vënia e tyre në Depon e Regjistraturës, si dhe mbajtja e të gjitha vulave katrore dhe rrethore.
Është bërë asgjësimi i dokumenteve në bazë të listës së shenjave të klasifikimit të dokumenteve me afatet e ruajtjes, ku është dhënë pëlqimi nga Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës dhe nga Arkivi Ndërkomunal i Mitrovicës.
Në vitin 2024, posta e cila është pranuar dhe dërguar nga Qendra për Shërbimin me Qytetarë/Arkivit në bazë të librave përkatëse, do t'i japim si në vijim:
Në librin e ekspedicionit në vend që është për shpërndarjen e postës se thjeshtë (zakonshme) brenda Komunës së Skenderajt, përmes këtij libri janë dërguar në adresa të caktuara gjithsej **2550** shkresa.
Në librin e dorëzimit të postës personalisht që është për postën rekomande, nga fahu postal i Komunës në PTK-në, janë pranuar gjithsej **353** shkresa.

Në librin e postës së dërguar nga komuna për në PTK-në, për në adresat e caktuara, janë dërguar gjithsej **637 shkresa.**

Në qendrën për shërbime me qytetarë/arkivë nga data **01/01//2024** deri me datën **31/12/2024,** janë pranuar gjithsej **57993** lëndë për të gjitha organet e komunës së Skenderajt ( Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës dhe të gjitha drejtorive ), ku e kemi të pasqyruara si në vijim:

---

**Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjedhjes**

**01/01/2024 - 31/12/2024**

| Shkurtesa | Përshkrimi | Pranuar | Në Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshtë | Pezulluar | Ceduar | Anuluar | Përfunduar | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lëndë | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| DA | Drejtoria për Administratë | 0 | 0 | 3,233 | 26 | 0 | 0 | 0 | 40 | 34,726 | 38,025 |
| DA | Drejtoria për Arsim | 0 | 2 | 774 | 335 | 0 | 2 | 0 | 23 | 0 | 1,136 |
| DBPZHR | Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural | 0 | 0 | 337 | 17 | 0 | 2 | 0 | 20 | 0 | 376 |
| DEFZH | Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim | 0 | 0 | 3,486 | 3 | 1 | 0 | 0 | 30 | 0 | 3,520 |
| DKRS | Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport | 0 | 1 | 128 | 20 | 1 | 2 | 0 | 1 | 0 | 153 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DUNMA | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit | 0 | 3 | 558 | 4 | 0 | 60 | 1 | 15 | 0 | 641 |
| DSHP | Drejtoria për Shërbime Publike | 0 | 1 | 458 | 66 | 2 | 6 | 0 | 22 | 0 | 555 |
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 1 | 17 | 2,821 | 32 | 0 | 380 | 0 | 40 | 0 | 3,291 |
| DGJKP | Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi | 1 | 39 | 6,246 | 49 | 1 | 20 | 1 | 57 | 0 | 6,414 |
| KK | Kuvendi i Komunës | 0 | 0 | 128 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 130 |
| KK | Kryetari i Komunës | 0 | 733 | 1,972 | 24 | 0 | 5 | 1 | 32 | 0 | 2,767 |
| DZhENIT | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm | 0 | 14 | 338 | 24 | 1 | 0 | 0 | 4 | 0 | 381 |
| DIK | Drejtoria e Inspektoratit Komunal | 0 | 9 | 302 | 25 | 0 | 0 | 0 | 6 | 0 | 342 |
| DPP | Drejtoria e Prokurimit Publik | 0 | 1 | 255 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 260 |
| | | 2 | 822 | 21,036 | 625 | 6 | 477 | 3 | 296 | 34,726 | 57,993 |

NJËSIA E TRANSPORTIT

Kjo njësi ka pranuar kërkesat e sektorëve të ndryshëm të komunës për transportin e zyrtarëve në udhëtime zyrtare, është kujdesur për gjendjen e automjeteve zyrtare, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre. Ka mbajtur evidencë për nisjet dhe kthimin e tyre në orarin zyrtar, regjistrimin e tyre sipas rregullave në fuqi, mirëmbajtjen dhe kontrollin e sistemit të GPS-ve në automjetet zyrtare të Komunës së Skenderajt, janë kryer edhe punë në mirëmbajtje të objektit të komunës dhe objekteve tjera përcjellëse.

- **ZYRA PËR PËRKTHIME**

Zyrtari për përkthime ka përkthyer **1100** faqe të dokumenteve, duke përfshirë të gjitha aktet që janë nxjerr nga ekzekutivi dhe kuvendi komunal si; vendime të ndryshme, rregullore, konkurse, akt emërime, kërkesa dhe shkresa tjera zyrtare, duke respektuar obligimet ligjore në aspektin e dygjuhësisë. Njëkohësisht ky zyrtar ka bërë edhe përkthim simultant në takimet e ndryshme me komunitetin pakicë në komunën e Skenderajt.

- **Sektori për Integrime Evropiane, DNJ dhe Barazi gjinore**

Sektori i IEDNJBZ, në bazë të planit të punës për vitin 2024, ka kryer punë në veprime dhe aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për avancimin e të drejtave për të gjithë, koordinimin dhe raportimin e obligimeve që bien mbi komuna nga Agjenda Evropiane, pa lënë anash këshillimet dhe udhëzimet e organeve komunale për respektimin e të drejtave të njeriut në aspektin e barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve, mos diskriminimit, të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, si dhe janë monitoruar aktivitetet e institucionit dhe veprimtaritë publike që janë nën kompetencat dhe përgjegjësitë e sektorit si në vijim:

- Shënimi i 8 Marsit – Dita Ndërkombëtare e Gruas.
- Organizimi i Festës së 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
- Subvencionimi i OJQ-ve lokale, gjithsej dhjetë – vlera e përgjithshme 10.000 euro
- Rekomandime për Drejtorinë e Arsimit, Bujqësisë, Zhvillimit Ekonomik, dhe Kulturës Rinisë dhe Sportit sa i përket ndarjes së subvencioneve dhe bursave.
- Raportimi në kohën e kërkuar për çështjen e zbatimit të barazisë gjinore dhe ato për të drejtat e njeriut nga MAPL- ZKM –OSBE etj.
- Raportimet periodike për obligimet që bien mbi komuna nga Agjenda Evropiane
- Takime të rregullta të mekanizmit kundër dhunës në familje.
- Tetori - muaji kundër kancerit të gjirit (aktivitete të ndryshme njëmujore).
- 18 Tetor - hapja e fushatës vetëdijësuese në parandalimin e trafikimit me njerëz (aktivitete gjatë 30 ditëve).
- Shpërndarja e posterëve vetëdijësues

- Ligjerata nëpër shkolla të nivelit komunal kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe kundër dhunës në familje në bashkëpunim më Policinë e Kosovës.
- Shënimi i Ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar, 3 Dhjetori, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.
- Shënimi i 25 Nëntorit - Dita ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas (16 ditë aktivizim).
- Shënimi i 10 Dhjetorit – Dita ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme.

- **ZYRA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE**

Kryhen punë të përditshme të zyrës së TI-së si: testimi i rrjetit, testimi i aplikacionit të intranetit, gjendjes civile, tatimit në pronë, fribalancit, kadastrit, e-arkivës, e-pasurisë, ueb faqes zyrtare të komunës, 6 Zyrave të GJC, QKMF-së, QPS-së, Zyrës së Punësimit, QRA-së, Kompleksit Memorial "Adem Jashari", Zyrës për Komunitete etj. Zyra e TI-së ka kryer edhe këto punë:

- Pajisja me licenca softuerike
- Janë mirëmbajtur dhe mbikëqyrur vazhdimisht 2 linqet, me QRC/QRA ( përmes kabllos optike) dhe QPS ( përmes VPN )
- Është mirëmbajtur dhe mbikëqyrur vazhdimisht linku përmes fibrit optik në QKMF
- Është riaktivizuar linku në Qendrën e Kulturës dhe Artit " Hasan Prishtina" pas dëmtimit të kabllos optike (është ndërruar kabllo optike )
- Është mirëmbajtur dhe mbikëqyrur vazhdimisht linku në "Kompleksin Memorial "Adem Jashari"
- Është mirëmbajtur vazhdimisht webfaqja zyrtare e komunës në aspektin teknik të administrimit
- Është mirëmbajtur konzola për menaxhim të e-mailit zyrtar ( Active directory )
- Janë hapur mbi 50 llogari të reja zyrtare
- Për çdo seancë të asamblesë komunale është montuar kamera e Teleprezencës dhe është transmetuar drejtpërdrejt seanca përmes webfaqes së komunës nga kanali në Youtube dhe janë ruajtur incizimet
- Nga zyra e TI-së, janë bërë servisimet e mbi 50 kompjuterëve të komunës
- Janë futur në DOMAIN qeveritar 50 kompjuterë të rinj zyrtarë dhe janë rifutur në domen qeveritar rreth 20 kompjuterë të cilët kishin probleme të ndryshme me domenin qeveritar
- Janë instaluar apo riinstaluar rreth 40 printerë dhe skanerë
- Është mbikëqyrur dhe menaxhuar kontrata e AQP-së për shfrytëzim të paisjeve (fotokopje, printerë, skanerë ) me qera nga data 1 Janar 2020
- Pjesëmarrja në takime dhe konferenca të ndryshme me Kolegjiumin e TI-ve

- Sipas nevojës është intervenuar nëpër 6 Zyrat e Vendit, Kompleksin Memorial "Adem Jashari" dhe Zyrën e Komuniteteve rreth problemeve me rrjet dhe pajisje, si dhe për përdorim të kompjuterit dhe e-mailit zyrtar.
- Nga zyra e TI-së, sipas nevojës është asistuar tek të gjithë zyrtarët komunalë për përdorim të kompjuterit, aplikacioneve, emailit zyrtar dhe sipas nevojave të zyrtarëve.
- Pjesëmarrja në punëtorinë 3 ditore për webfaqen e re zyrtare të komunës
- Janë krijuar llogari të reja për zyrtarët komunalë në aplikacionin e Intranetit
- Janë ruajtur raportet nga aplikacioni i intranetit për vitin 2024
- Është asistuar vazhdimisht te asamblistët për ndërrimin e fjalëkalimit dhe problemet me llogari zyrtare
- Është bërë migrimi i të dhënave nga webfaqja e vjetër, në webfaqen e re

Janë kryer edhe shërbime tjera që janë në kuadër të Drejtorisë së Administratës në bashkëpunim më njësitë tjera organizative të Komunës së Skenderajt.

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Aktivitetet që janë realizuar gjatë vitit 2024:

1. Është realizuar monitorimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
2. Është realizuar ofrimi i informacioneve rreth granteve për mbështetjen e fermerëve nga MBPZHR,
3. Ndarja e granteve për fermerët e Skenderajt nga DBPZHR për vitin 2024 dhe bashkëpunimet me donatorët, ku në kuadër të këtyre granteve janë shpërndarë këto pajisje bujqësore:
    - 35 copë mbjellëse misri,
    - 35 copë mbjellëse gruri,
    - 97 përfitues fidanë speci, tranguj dhe domate,
    - Serra për 74 familje përfituese,
    - Pula vojse për 100 familje përfituese ( nga 40 pula),
    - Puse për ujë të pijshëm për 68 familje,
    - 8 copë laktofriza,
    - 3 copë motokultivator,
    - 9 përfitues me nga 8 koshere me bletë dhe mjete të punës
    - 4 përfitues me inkubator për zogj

4. Në kuadër të punëve të përditshme në drejtori janë realizuar edhe aplikimet për subvencione ku në këtë vit kanë aplikuar 1,762 fermerë për sipërfaqet e mbjella, 923 fermerë për subvencionim të plehut artificial dhe sasisë së grurit të dorëzuar.

5. Aplikimet për subvencione për qumësht dhe majmëri dy herë gjatë vitit 2024 ku kanë aplikuar mbi 123 fermerë.
6. Në kuadër të angazhimeve që ka drejtoria dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qentë endacakë kemi arritur marrëveshje për trajtimin e qenve endacakë me fondacionin zvicëran "StrayCoCo" ku gjatë vitit 2024 janë trajtuar rreth 375 qenë endacakë (kastrim dhe sterilizim) ndërsa janë trajtuar me eutanazi 45 qenë.
7. Është përfunduar procesi i dhënies me qira të vendgjuetisë "Drenica" dhe ka filluar menaxhimi i kësaj vendgjuetie sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.
8. Është realizuar monitorimi i procesit të korrje-shirjeve në të gjithë terrenin e komunës së Skenderajt nga ana e komisionit të formuar për këtë proces.

Janë organizuar trajnime në kuadër të projektit Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore në këto tema:

1. Kultivimi i pemëve frutore dhe mirëmbajtja e tyre.
2. Varietete, mbjellja dhe kultivimi i grurit.
3. Kultivimi i perimeve në serë dhe fushë të hapur.
4. Prodhimi higjienik i qumështit.
5. Kujdesi ndaj bletëve dhe kultivimi i tyre.
6. Të ushqyerit e lopëve qumështore gjatë fazës së laktacionit.

## DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK, NDËRMARRËSI, INOVACION DHE TURIZËM

Raporti i punës së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion e Turizëm, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara, konform me planin e punës për vitin 2024, dokumentet strategjike si: Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, Strategjia për Zhvillimin e Turizmit, si dokumente strategjike të cilat paraqesin vizionin dhe misionin e komunës.

Drejtoria gjatë vitit 2024 është angazhuar në gjetjen e investitorëve dhe donatorëve potencialë, të cilët kanë ofruar përkrahje për zhvillimin socio-ekonomik, përfshirë këtu:, UNDP, Banka Botëror, Qeveria Japoneze, Qatar Charity dhe Ëater for Life.

Ky raport paraqet në tabela për secilën njësi punët dhe aktivitetet e realizuara, duke përfshirë të dhënat e detajuara nga projektet kapitale, grantet për biznese, promovimin e turizmit dhe shërbimet për bizneset:

**-Projektet Kapitale:**

| Emri i Projektit | DONATORET | MUAJ/VITI | TE DHËNAT E PROJEKTIT |
|---|---|---|---|
| Shtegu i çiklizmit, në Bashkësinë Lokale Qirez | Komuna e Skenderajt | 2024 | Projekti synon që ta bëjë më atraktiv për vizitorët dhe banorët në qendrën historike të shtabi i UÇK-së në Likoc |
| Rregullimi i hapësirave të dhomave te zhveshtores për Klubin e Volejbollit për femra në Skenderaj. | UNDP<br>Komuna e Skenderajt | 2024 | Rregullimi i zhveshtores për Klubin e Volejbollit për femra. |
| Ndërtimi i shëtitores natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina | Komuna e Skenderajt | 2024-25 | Ndërtimi i një shëtitoreje dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina |
| Rregullimi shtratit të lumit Klina | Komuna e Skenderajt<br>MZHR | 2023-24-25 | Rregullimi i shtratit të lumit duke filluar nga Llausha në drejtim të Kuçicës. |
| Ndërtimi i çerdhes për fëmijë - vazhdimi i aneksit të dytë | Komuna e Skenderajt<br>MZHR | 2024 | Pjesa e fundit e projektit |
| Ndërtimi i shtigjeve për ecje: Kuçicë, Çyçavicë, Radishevë dhe Tushilë | Komuna e Skenderajt | 2023-2024 | Është ndertuar një shteg i ecjes në zonën Kucicë- Radishevë me gjatësi 23km |

- **Grante:**

| *GRANTET:* | *DONATORI:* | MUAJ/VITI | *TE DHENAT E GRANTIT:* |
|---|---|---|---|
| Grante për biznese ekzistuese dhe start-up | Komuna e Skenderajt | 2024 | Më qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe ofrimit të kushteve për punë brenda komunës, janë mbështetur 48 përfitues. |
| Grante në fushën e Turizmit | Komuna e Skenderajt<br>UNMIK | 2023-2024 | Komuna e Skenderajt ka përfituar një grand nga UNMIK së bashku me OJQ "Nomad Kosova". Projekti parasheh angazhimin e të rinjve në promovimin e natyrës. |
| Mbështetje për të rinj praktikë me pagesë në institucione | Komuna e Skenderajt<br>UNDP | 2024 | 16 të rijn kanë përfituar nga skema e praktikës me pagesë në institucione. |
| Programi për Demokraci Lokale | Komuna e Skenderajt<br>UNDP | Shtator, 2024 | Gjatë vitit 2024 janë përkrahur 12 organizata të shoqërisë civile të cilat realizojnë projekte në fushën e Bizneseve, Inovacionit dhe Turizmit. |
| Përkrahja e familjeve më ujë të pijes | Komuna e Skenderajt dhe Qatar Charity | 2024 | Si rezultat i marëveshjes paraprake nga viti 2023 parakusht për stabilitet socio-ekonomik, gjatë vitit 2024 kemi përkrahur 12 familje me ujë të pijes, përmes hapjes se bunarëve me OJQ-në "Qatar Charity", kryesisht në fshatra ku ujë i pijes përmes rrjetit është mungesë. |
| Rregullim të furnizimit me ujë të pijes | Ëater for Life | 2024 | Rregullimi dhe furnizimi me ujë të pijes për familje të ndryshme dhe paisje të tjera te nevojshme, 20 familje përfituese. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Grante për Start-up | Komuna e Skenderajt dhe Qatar Charity | Tetor-2024 | Në bashkëpunim me Qatar Charity, DZHENIT ka përzgjedhur 7 përfitues. Prej të cilave start up dhe biznese ekzistuese |
| | | | |

-DZHENIT ka ofruar shërbime për biznese dhe qytetarë që kanë shprehur interesim për hapjen e bizneseve të reja, ndryshimin ose edhe shuarjen e tyre.

**NJESIA PËR BIZNESE**

| **RAPORTI VJETOR 01.01 DERI 31.12.2024** | |
|---|---|
| **Sektori Zhvilim Ekonomi, regjistrim të biznesit** | **Totali-24** |
| Biznese të reja të regjistruara | 171 |
| Ndryshime tjera në biznes | 101 |
| Çregjistrim i bizneseve | 32 |
| Ndërrim Certifikatave | 4 |
| Vërtetime/ Informata | 126 |
| **Totali** | **434** |

-Bazuar në rregulloren komunale për taksa tarifa dhe gjoba, të miratuar nga asambleja komunale, DZHENIT merret edhe me taksen në biznese, shpërndarjen e tyre si dhe mbahet evidenca për këtë taksë.

-DZHENIT, gjatë vitit 2023 ka realizuar edhe një varg aktivitetesh:

| ***AKTIVITETET:*** | **MUAJ/VITI** | ***TË DHËNAT E AKTIVITETIT:*** |
|---|---|---|
| Vizita në biznese | 2024 | Janë vizituar bizneset për t'i parë nga afër nevojat dhe kërkesat e tyre. |
| Donacion me lodra për repartin e pediatrisë dhe 7 | Mars 2024 | Aktivitet i realizuar së bashku me UNDP |

| | | |
|---|---|---|
| karroca per repartin e urgjencës ne QKMF | | |
| Furnizim me lule, pemë dhe ulëse për parkun e shtëpisë së të moshuarve | Maj 2024 | Aktivitet i realizuar së bashku me UNDP |
| Panairi i Turizmit dhe Artizanalëve | 2024 | Komuna Skenderajt ka organizuar panairin për të prezantuar produkte dhe shërbime nga fusha e turizmit dhe artizanalëve në këtë panair përgjatë 3 ditëve. |
| Furnizim me pajisje të fitnesit për Klubin e Volejbollit f. në Skenderaj | Gushte 2024 | Aktivitet i realizuar së bashku me UNDP |
| Përgatitjen e projekt-propozimeve | 2024 | Projekt propozime janë dërguar në Ambasadën Japoneze dhe MZHR,MAPL dhe donatorë të tjerë. |
| Janë organizuar punëtori për Komunën e Skenderajt në bashkëfinancim me donatorë të ndryshëm si NDI dhe USEDI,UNDP,„Humans Vita'' etj. | 2024 | Përgatitja për tregun e punë, fuqizimi ekonomik si dhe gratë në fushën e Turizmit ishin temat e tryezave |
| Panairi në Kordinim me women for women | Shator 2024 | Panairi në Kordinim me women for women si komunë partnere në mesin e 6 komunave tjera si dhe gratë që kanë qenë pjesë e trajnimeve nga w4w kanë pasur mundësinë që të aplikojnë për grante nga një konkurs i brendshëm në këtë ojq. |

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI E MIRËQENIE SOCIALE**

Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale bëjnë pjesë Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH), Qendra për Pune Sociale (QPS) si dhe Shtëpia për Persona të Moshuar dhe pa përkujdesje familjare (SHPMPF).

Gjithashtu në Kuadër të Kujdesit Dytësor Shëndetësor funksionon Qendra e Shëndetit Mendor, ku trajtohen pacientët me çrregullime mendore. Ky institucion është nën kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë.

**-I- ADMINISTRATA E DSHMS-së**

Gjatë periudhës **01.01.2024 – 31.12.2024**, përkatësisht një viti të punës nga zyrtarët e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë kryer të gjitha shërbimet, si në raport me pritjen e palëve ashtu edhe në raport me lëndët apo kërkesat që kemi pranuar.
Në këtë periudhë kohore kemi pasur mbi **3291 lëndë** e kërkesa të ndryshme që janë drejtuar në DSHMS.

| **Shkurtesa** | **Përshkrimi** | **Pranuar** | **Në Proces** | **Miratuar** | **Refuzuar** | **Hedhur Poshtë** | **Pezulluar** | **Ceduar** | **Anuluar** | Përfunduar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 1 | 17 | 2,821 | 32 | 0 | 380 | 0 | 40 | 0 |
| | | 1 | 17 | 2,821 | 32 | 0 | 380 | 0 | 40 | 0 |

- Numri i aplikimeve për Subvencionim në shumë prej 200 Euro të fëmijëve të posalindur është 501, shuma e realizuar është 54,100.00 Euro për 274 fëmijë.
- Numri i aplikime për subvencionim për mjete financiare per barna dhe shërim është 426, shuma e realizuar 69,820.00 Eurë
- Numri i familjeve të përkrahura me pagesë të qerasë është 8, shuma e realizuar 8,160.00Euro.
- Numri i familjeve të përkrahura me renovim të shtëpive (raste sociale) është 5, shuma e realizuar 9,100.00Euro.

Gjendjen e banimit social në periudhën Janar- Dhjetor 2024

Duke u bazuar në ligjin nr.03/l-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit social, Komuna e Skenderajt kërkesave të qytetarëve rreth çështjes së strehimit iu del në ndihmë në disa forma duke iu ofruar:

- Banesa sociale
- Ndërtim të shtëpive
- Renovim të shtëpive
- Bonus të banimit (pagesë të qeras)

-Komuna ka në pronësi tri objekte të banimit social me gjithsej 100 njësi banimi.

- Objekti nr-I- kemi të strehuara 26 familje me gjithsej 128 anëtarë, prej të cilave kemi familje te dëshmorëve, veteranëve si dhe atyre në asistencë sociale.
- Objekti nr-II- 25 familje me gjithsej 94 anëtarë, familje këto të cilat janë duke i shfrytëzuar banesat me kohë të caktuar dhe i përkasin kategorive të ndryshme sociale.
- Objekti nr-III- 49 familje me gjithsej 152 anëtarë, edhe në këtë objekt familjet të cilat janë vendosur i përkasin kategorive të ndryshme sociale e të cilat janë nevojtare për banim.

Kjo gjendje është sipas vlerësimit të fundit të bërë nga komisioni vlerësues i caktuar nga Kryetari i Komunës për këtë vit. Këto familje janë të vendosura në vitet paraprake por ndryshojnë varësisht se cila bën zgjidhjen e banimit e liron dhe vendoset familja tjetër në nevojë për strehim.

Ndërsa në këtë periudhe kohore prej 12 muajsh të vitit 2024:

**-Banesa sociale**: 2 familje kanë plotësuar kriteret për vendosje, dhe janë vendosur në banesa pas lirimit nga shfrytëzuesit e mëparshëm.

**-Ndërtim të shtëpive:** kemi perfunduar ndërtimin e dy (2) shtëpive në bashkëpunim me Shoqatën humanitare "Bereqeti " dhe Islamik Relief.

**-Renovim të shtëpive:** 5 familje i kemi ndihmuar me renovim të shtëpisë nga Subvencionet e DSHMS-së. Ndërsa kërkesa tjera janë refuzuar sepse nuk kemi pasur mjete financiare të mjaftueshme për t'i ndihmuar të gjithë. Ndërsa nga ministria e linjës nuk kemi pasur të ndara mjete të cilat janë të dedikuara për këtë kategori.

**-Bonus banim (pagesë e qerasë):** kemi ndihmuar shtatë(6) familje me pagesën e qerasë në periudhë kohore prej tre, gjashtë deri në dymbëdhjetë (3-6-12) muaj për secilën në shumë mujore prej 170 Euro.

## -II- KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR (KPSH)

Kujdesi Parësor Shëndetësor në Komunën e Skenderajt ofrohet përmes QKMF, QMF-ve dhe AMF-ve për rreth 52,000 banorë të Komunës me një staf prej 184 punëtorësh.

Shërbimet e KPSh-së ofrohen shumë më tepër nga QKMF edhe pse mbulon vetë **19%** të popullatës (shih grafikonin). Kështu, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, nga gjithsej vizita dhe shërbime tjera shëndetësore të ofruara në gjithë KPSh, vetëm në QKMF janë realizuar **92%** e krejt shërbimeve të kujdesit shëndetësor të ofruara në Komunën e Skenderajt.

**Vizitata mjekësore në raportin QKMF, QMF dhe AMF**




KPSH në Skenderaj ka të zhvilluar rrjetin organizativ që përbëhet nga 1 QKMF, 5 QMF, si dhe 8 AMF:

| QKMF | QMF | AMF |
|---|---|---|
| | | 1. Polac |
| | 1. Runik | 2. Rezallë |
| | 2. Turiçec | 3. Llaushë |
| | 3. Likoc | 4. Açarevë |
| 1. **Skenderaj** | 4. Cirez | 5. Izbicë |
| | 5. Prekaz i Ep. | 6. Klladërnicë |
| | | 7. Çubrel |
| | | 8. Klinë e Ep. |

## 1.RESURSET NJERËZORE

| Stafi | Numri | Meshkuj | Femra | Totali |
|---|---|---|---|---|
| MJEKË FAMILJARË | 8 | 3 | 5 | 8 |
| MJEKË TË PËRGJITHSHËM | 23 | 9 | 14 | 23 |
| STOMATOLOGË | 3 | 3 | 0 | 3 |
| MJEKË KONSULTANTË | 3 | 3 | 0 | 3 |
| INFERMIERË TË MF | 85 | 20 | 65 | 85 |
| MAMI | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TEKNIKË / ASISTENTË STOMATOLOGË | 6 | 2 | 4 | 6 |
| TEKNIK I DIAGNOSTIKËS | 7 | 2 | 5 | 7 |
| PROFESIONISTË TJERË SHËNDETËSORË | 7 | 2 | 5 | 7 |
| TË TJERË | 42 | 27 | 15 | 42 |

**Shërbimet e kontraktuara shëndetësore**

| STAFI | Numri | Meshkuj | Femra | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **KOSOVA Med**<br><br>**Staf Shëndetsor** | **25** | **3** | **22** | **25** |
| **Eko Natyra** | **9** | **2** | **7** | **9** |

**Në menyrë tabelare janë paraqitur të gjitha shërbimet e ofruara gjatë vitit 2024 në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare si dhe QMF dhe AMF.**

**QKMF SKENDERAJ,RAPORTË I VIZITAVE DHE SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE JANAR-DHJETOR 2024**

| Nr. | Sherbimi | Viz mjeku | Viz e pers | R spit | R spec | R Lab | RTG | Injekcion | Infuzione | P,L,P Pla | Inhalim | Vaksina | Oremas | M dhe | Fataksi | EKG | Laborator | EHO | RTG | Ortopa | M.Or | Psikol | Keshill | Shtepi | Transp | Barnatori | O.Sajet | Sh.Ners | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjek.e pë | 55821 | 29082 | 47 | 4831 | 8136 | 3915 | 17318 | 16318 | | | | | | | 47 | | | | | | 476 | 3776 | | 447 | | 543 | | 140757 |
| 3 | Urgjenca | 27193 | | 3469 | | 539 | 597 | 8659 | 5406 | 1741 | | | | | | 2761 | | | | | | | | 324 | 1625 | | | | 52314 |
| 4 | Laborator | | | | | | | | | | | | | | | | 129760 | | | | | | | | | | | | 129760 |
| 5 | Vaksinimi | | | | | | | | | | | 11331 | | | | | | | | | | | | | | | | | 11331 |
| 6 | Stomatolo | 4345 | | | | | | | | | | | 537 | 618 | 1071 | | | | 92 | | | | | | | | | 2994 | 9657 |
| 7 | Kosova M | 2312 | | | | | | 7430 | 19884 | 5396 | 407 | 142 | | | | | 4305 | | | | | | | | 3503 | | | 2059 | 45438 |
| 10 | Inhalatori | | | | | | | | | | 1223 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1223 |
| 11 | E.K.G. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 12 | BARNATORJA | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 20439 | | | 20439 |
| 13 | R.T.G. | | | | | | | | | | | | | | | | | 2909 | 8194 | 124 | 109 | | | | | | | | 11336 |
| 14 | Pediatria | 10311 | 503 | 21 | 292 | 1546 | 148 | | | | 1452 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 14273 |
| 15 | Lidhëtorja | | | | | | | | | 13458 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 13458 |
| | DAT | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 130 | 130 |
| 16 | QMF Run | 3618 | 523 | | 359 | 388 | 220 | 1375 | 831 | 1088 | 122 | 465 | | | | | 117 | | | | | | | | | | | | 9104 |
| 17 | QMF Turk | 2471 | 240 | | 138 | 176 | 152 | 2596 | 1101 | 919 | 264 | 495 | | | | | 70 | | | | | | | | | | | 175 | 8797 |
| 18 | QMF. Qir | 1894 | 600 | | 178 | 164 | 95 | 794 | 447 | 1368 | 145 | 355 | | | | | 40 | | | | | | | 68 | | | | 80 | 6228 |
| 19 | QMF. Liko | 2220 | 130 | | 96 | 146 | 69 | 951 | 626 | 1093 | 29 | 429 | | | | | 183 | | | | | | | | | | | 100 | 6072 |
| 20 | QMF.Pre | 1415 | 109 | | 240 | 138 | 105 | 325 | 85 | 422 | 83 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 2922 |
| 22 | Amb. Pola | 461 | 30 | | 12 | 25 | 8 | 160 | 24 | 209 | 38 | | | | | | | | | | | | | | | | | 147 | 1114 |
| 23 | Amb.Klin | 221 | 63 | | 13 | 21 | 5 | 215 | 27 | 199 | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | 471 | 1241 |
| 24 | Amb. Re | 313 | 25 | | 8 | 24 | 12 | 96 | 46 | 203 | 16 | | | | | | | | | | | | | | | | | 37 | 780 |
| 25 | Amb. Kilo | 9 | | | | | | 67 | 21 | 60 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 135 | 292 |
| 26 | AMF Izbicë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 27 | AMF Qubrel | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 28 | AMF Llaushë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 29 | AMF Aqarevë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 30 | T O T A L I | 112604 | 31305 | 3597 | 6167 | 11301 | 5326 | 39986 | 44816 | 26156 | 3785 | 13217 | 537 | 618 | 1071 | 2808 | 134475 | 2909 | 8286 | 124 | 109 | 476 | 3776 | 392 | 5575 | 20439 | 543 | 6328 | 486666 |

QKMF . SKENDERAJ ;03.01.2025

Kryeinfermieri: Fatmir Osmani 048 906 386 fatmir.b.osmani@rks-gov.net

## Projektet e realizuara

- Renovimi i AMF në Rezallë.
- Furnizimi me paisje mjekësore në shërbimin Labaratorik.
- Furnizimi me paisje mjekësore në shërbimin Radiologjik.
- Servisimi i paisjeve Radiologjike.
- Fillimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë.
- Realizimi i vizitave sistematike nëpër të gjitha shkollat fillore.
- Realizimi i vizitave shtëpiake të kujdesit paliativ.

## Raporti i te hyrave nga participimi dhe certifikata mjekësore

| Totali vjetor | 2023 | 2024 | Diferenca | % |
|---|---|---|---|---|
| Totali i participimi | 26,9384.00 | 32,083.00 | 5,099.00 | 18.9 |
| Totali i Certifikatave | 4,500.00 | 4,740.00 | 240.00 | 0.53 |
| **Totali i participimit dhe Certifikatave për Punësim 20023-2024** | 31,484.00 | 36,823.00 | 5,339.00 | 16.95 |

## -III- QENDRA PER PUNE SOCIALE

Qendra për Punë Sociale në Skenderaj është Institucion Komunal i cili funksionon nën mbikëqyrjen e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DKSHMS-së) dhe Departamenti për PSF të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në funksion të të gjithë qytetarëve të saj në gjendje të nevojës sociale, pa marrë parasysh moshën, gjininë, nacionalitetin, religjionin etj.

I.SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Në mbështetje të Ligjit NR. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare,dhe Ligjit për Familjen i Kosovës Ligji Nr.2004/32, QPS-ja në rrethanat kur ka pasur informata dhe ka vlerësuar se mungon përkrahja e familjes ose në rastet kur ajo nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e ndonjë individi i ka ndërmarrë të gjitha veprimet konform misionit që ka për: fëmijët e braktisur, fëmijë në situatë rruge, fëmijë me sjellje asociale, fëmijë në konflikt me ligjin, fëmijë të prindërve të ndarë apo në proces të shkurorëzimit, fëmijë me aftësi të kufizuara, delikuentet e mitur, persona me çrregullime mendore, për strehim në Institucionet rezidenciale, viktima të dhunës në familje dhe trafikim, prindër vetushqyes, të moshuar në nevojë për strehim etj.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar aktvendime-vërtetime për: Ushtrim i të drejtës prindërore, zotësi veprimi, humbje të shtetësisë, për punësim etj.

Menaxhimi i Skemës së pagesave për fëmijët me aftësi të kufizuar nga buxheti i MFPT si dhe për fëmijët në strehim familjar pa përkujdesje prindërore.

Shërbimet Sociale kanë realizuar edhe këto aktivitete në fushën e përgjegjësisë që ka edhe me akterët tjerë si:

Trajnime dhe seminare te ndryshme:

- Tryezë diskutimi rreth menaxhimit të migrimit
- Gjithëpërfshirja për evidentim të rasteve të DHF-Ministia e Drejtësisë
- Takim pune me Diakoni Kosova
  Inicimi i qasjes multidisiplinare dhe shkëmbimi i metodologjive,procedurave dhe protokolleve të ndryshme të punës në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve HANDIKOS 2 ditor.
- Monitorimi dhe Inspektimi i Sherbimeve Sociale dhe Familjare KOMF 2 ditor
- Forumi i bashkëpunimit ndërsektorial në Trajtimin e Viktimave dhe Viktimave Potenciale të Trafikimit me qenje njerëzore.
- Mbrojtja e viktimave dhe parandalimi i Trafikimit me njerëz MVPT 3 ditor
- Trajnim për Strehim familjar dhe Adoptim
- Takim me gratë dhe mekanizmat mbrojtës PK,QPS,MV,Strehimorja 1 ditor
- Menaxhimi i rasteve me rrezik të mesëm dhe të lartë si dhe mbikëqyrja në menaxhimin e rasteve individuale TDH 2 ditor
- Takim me drejtor të Shkollave në Stacionin policor Skenderaj-Siguria në Shkolla
- Planifikimi dhe Buxhetimi-Save the Children-2 Ditor
- Takime të rregullta me Mekanizmat komunalë kundër Dhunës në Familje
- Vlerësimet pedagogjike të nxënësve me nevoja të veqanta-të rregullta DKA
- Takime të rregullta Plani Lokal i veprimit KKR të Riatdhesuarit
- Puna me Migrantë, Refugjatë, të Rikthyer dhe të Riatdhesuar në Kosovë

Punë pas orarit të rregullt të punës, vikendeve dhe festave të ndryshme zyrtarët kanë prezantuar në polici në disa raste (trafikim,dhunë në familje dhe delikuenca e të miturve).

Pasqyra e shërbimeve sociale të ofruara:

| | **Shërbimet e ofruara** | **Rastet** |
|---|---|---|
| 1 | Vendim i caktimit të kujdestarisë për fëmijë pa prindër | 2 raste –me 3 femijë |
| 2 | Ushtrim i të drejtës Prindërore - përfaqësime (Pasaporte) | 191 |
| 3 | Besim i fëmijëve | 9 |
| 4 | Fëmijë me sjellje asociale | 40 |
| 5 | Pëlqim martese për të mitur | 2 |
| 6 | Fëmijët me nevoja te veçanta | 17 kerkesa te reja |
| 7 | Viktima të dhunës ne familje | 53 |
| 8 | Sanim i marrëdhënieve bashkëshortore | 18 |
| 9 | Përfaqësime në Gjykatë | 52 |

| | | |
|---|---|---|
| 10 | Viktima të Dhunës Familjare - dërgimi në strehimore | 6 |
| 11 | Të moshuarit për strehim | 1 kerkesë |
| 12 | Këshilla martesore | 140 |
| 13 | Prindër të penguar në ushtrimin e të drejtës prindërore | 2 |
| 14 | Vazhdim kontratave të strehimit familjar | 12 |
| 15 | Fëmijë në strehim familjar | 12 |
| 16 | Intervenime në bazën e të dhënave | 1225 |
| 17 | Vërtetime për aplikim për shtetësi të huaj | 25 |
| 18 | Vërtetim Armëmbajtje | 283 |
| 19 | Vërtetim për punë | 224 |
| 20 | Kontakte te rregullta me fëmije te realizuara ne QPS | 21raste 2x në muaj |
| 21 | Kontakte me fëmije gjatë vikendeve | 6 Raste |
| 22 | Konstatime zyrtare dhe konkluzione | 21 |
| 23 | Prezantimi në polici | 121 |
| 24 | Braktisja e shkollës | 1 |
| 25 | Braktisje nga familja dhe shkolla | 2 |
| 26 | Kërkesë për Adoptim | - |
| 27 | Vizita familjare | 125 |
| 28 | Viktimë potenciale e Trafikimit- të dyshuara nga organi kompetent | 2 |
| 29 | Ofrimi i shërbimeve Psikologjike | 8 raste - fëmijë |
| 30 | Pëlqim për udhëtim për të mitur | 16 |
| 31 | Përdorues i substancave narkotike | 1 |
| 32 | Probleme psikike | 2 |
| 33 | Ngacmim seksual ndaj të miturave | 1 |
| 34 | Strehim Familjar jashtë familjes, fëmijë potencialë për braktisje | 1 Rast |

| | | |
|---|---|---|
| 35 | Kujdestari për raste të veçanta | 1 rast |

-Sektori i Asistencës Sociale

-Në vitin 2024 të gjitha lëndët janë trajtuar në kohë duke respektuar afatet ligjore.
-Gjatë ketij viti kemi pranuar 39 kërkesa të reja.
-Në krahasimin e të dhënave Departament-ATK janë gjetur 45 raste prej të cilave 30 i kanë kthyer mjetet ndërsa pjesa tjetër janë dërguar në Departament dhe janë në procedura gjyqësore. Gjatë këtij viti janë lëshuar edhe 113 vërtetima për shtetësi, shtojer, fakultet etj. Prej të cilëve shumica kanë qenë me pagesë.
-Në vitin 2024 kanë filluar të aplikohet edhe SAS-projekti ku për tre muaj kemi pasur 520 familje që kanë janë verifikuar prej të cilave 179 kan qenë përfitues të skemës SAS.

## -IV- SHTËPIA PËR PERSONA TË MOSHUAR DHE PA PËRKUJDESJE FAMILJARE (SHPMPF).

Gjatë vitit 2024, numri i rezidentëve ka pasur variacione, por momentalisht kemi gjithsej 24 rezidentë:

- 14 Femra
- 10 Meshkuj

Mosha mesatare e rezidentëve është 75 vjeç. 23 nga këta janë të nacionalitetit shqiptar dhe janë të shpërndarë nga këto Qendra për Punë Sociale(QPS):

- 12 nga QPS-Skenderaj
- 5 nga QPS-Mitrovicë
- 2 nga QPS-Vushtrri
- 1 nga QPS-Klinë
- 4 nga QPS-Drenas

GJENDJA SHËNDETSORE E REZIDENTËVE
Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë e qëndrueshme. Pavarësisht disa problemeve të vogla shëndetësore që janë trajtuar nga mjekët e institucionit, kemi pasur një numër të vogël ndryshimesh krahasuar me muajt e kaluar. Shërbimet shëndetësore, sociale dhe higjienike janë realizuar brenda institucionit 24 orë.

Në SHPMPF ofrohen shërbime si: ushqim, veshmbathje, vizita mjekësore, shërbime fizioterapeutike, përkujdesje shëndetësore.

## DREJTORIA E PROKURIMIT

Për të realizuar zbatimin e detyrave të punës si dhe për ti përmbushur objektivat e saja të punës, Drjetoria e Prokurimt duke pasur një bashkëpunim me ZKA-në dhe me gjitha njësite kërkuese kemi arritur qe ta realizojmë me sukses Planifikimin e prokurimit 2024- të. Drejtoria e Prokurimit, në kuader të autorizimeve dhe përgjegjësive të saj që i ka në bazë të ligjit, udhëzimeve administrative nga KRPP-ja dhe akteve normative komunale ka përgatitë dhe prezantuar për shqyrtim pranë organeve kompetente, si atyre qendrore dhe atyre komunale, raporte mbi prokurimet, për gjitha shtyllat e buxhetit.

- Në vazhdim po paraqesim në detaje të arsyeshme Raportin – objektivat e Drejtorive Komunale, të cilat Drejtoria e prokurimit ka realizuar gjatë vitit fiskal 2024, sipas kategorive, punë, shërbime dhe furnizime, për t'i përmbushur kërkesat gjegjësisht planifikimet e të gjitha shtyllave buxhetore – njësive shpenzuese të Autoritetit Kontraktues:

KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE VITI FISKAL 2024

| Të Hyra Vetanake (1) ose Buxh.i Kons.i | Numri rendor i prokurimit | Klasifikimi (2 shifrat e para të FPP) | Titulli i aktivitetit të prokurimit |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| ,001 | 643-23-12055-2-1-1 | 93 | 059 - Sigurimi Fizik i objekteve te Komunes se Skenderajt - Ritender |
| ,002 | 643-23-12339-2-2-1 | 93 | 085 - Mirëmbajtja dhe servisimi për ngrohje, ftohje, ventilim dhe klimatizim në objektin e Komunës, Shtëpinë e Kulturës me Palestrën sportive, QKMF-së, AMF-të në Bashkësi lokale, SHPMPF dhe QPS-së në Skenderaj |
| ,003 | 643-23-5477-5-2-1 | 45 | 044 - Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve brenda territorit të komunës së Skenderajt |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ,004 | 643-23-4426-5-1-1 | 45 | 026 - Rregullimi i Subqendres - Likovc - Ritender |
| ,005 | 643-23-3642-5-1-1 | 45 | 027 - Rregullimi i subqendres - Qirez |
| ,006 | 643-23-13199-5-2-1 | 45 | 087 - Renovimi dhe mirëmbajtja e shkollave të mesme të Komunës së Skenderajt |
| ,007 | 643-24-498-2-2-1 | 63 | 001 - Pastrimi i automjeteve zyrtare, vullkanizimi, balancimi, montimi dhe demontimi i gomave në komunën e Skenderajt |
| ,008 | 643-23-8683-5-2-1 | 45 | 057 - Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë - Faza 1 - Ritender |
| ,009 | 643-23-8262-1-1-1 | 28 | 060 - Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit në Komunën e Skenderajt |
| ,010 | 643-23-12448-1-2-1 | 30 | 081 - Furnizim me tabela interaktive për nevojat e shkollave të komunës së Skenderajt - Ritender |
| ,011 | 643-24-2193-5-2-5 | 45 | 008-Asfaltimi i rrugës Skenderaj-Vushtrri - Punë shtesë 22-11388 |
| ,012 | 643-24-1779-1-3-6 | 01 | 013 - Furnizimi dhe mbjellja e luleve-drunjëve në hapësirat gjelbëruese të qytetit |
| ,013 | 643-24-1414-2-2-1 | 50 | 005 - Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të komunës së Skenderajt |
| ,014 | 643-24-1005-5-1-1 | 45 | 003 Ndertimi i urave në fshatrat Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Terrnavc, Tushilë dhe Kllodernicë , Komuna e Skenderajt |
| ,015 | 643-24-1553-1-2-1 | 01 | 009 - Furnizim me fidane speci, tranguj dhe domate |
| ,016 | 643-24-877-1-1-1 | 22 | 002 - Furnizim me mallra dhe shërbime për nevojat e DKRS-së dhe drejtorive tjera në Komunën e Skenderajt |
| ,017 | 643-23-13470-1-3-6 | 33 | 088 - Blerja e senzorit digjital për rentgen Retroalveolar |
| ,018 | 643-24-1767-5-2-5 | 45 | 012-Ndertimi i rrugës Kotorr-Qubrel-Ritender- Punë shtese - 12501 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ,019 | 643-24-1609-5-2-1 | 45 | 010 - Ndërtimi i çerdhes për fëmijë - vazhdimi i aneksit të dytë |
| ,020 | 643-24-3338-1-2-1 | 29 | 018- Shenjëzimi i pikës më të lartë dhe vendosja e një teleskopi vrojtues-Faza II |
| ,021 | 643-24-1323-1-3-6 | 24 | 004 - Furnizim me oksigjen medicinal për nevojat e QKMF-së |
| ,022 | 643-23-13612-1-2-1 | 30 | 089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komun s së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre. |
| ,023 | 643-24-3579-5-1-1 | 45 | 022 -Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Klinë, Polac, Makerrmal , Ticë, Kopiliq i epërme dhe Rakinicë |
| ,024 | 643-24-1520-5-2-1 | 45 | 011-Riparimi dhe zgjerimi i vendajeve për autobus dhe mbulimi i tyre |
| ,025 | 643-24-2990-5-2-1 | 45 | 016 - Kyqjet individuale në rrjetin e ujësjellësit në fshatin Burojë |
| ,026 | 643-24-3275-5-2-1 | 45 | 019 - Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në fshatrat Kuçicë, Çyçavicë, Radishevë, Tushilë, faza II |
| ,027 | 643-23-13658-1-3-6 | 33 | 091 - Furnizim me barna dhe material shpenzues - QKMF Skenderaj |
| ,028 | 643-24-3323-5-2-1 | 45 | 021 - Kyçja e kanalizimit lagjia Kodra - Polac |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ,029 | 643-24-3701-5-1-1 | 31 | NDRIQIMI PUBLIK NË QYTET DHE FSHATËRA |
| ,030 | 643-24-4249-5-2-5 | 45 | Asfaltimi i rrugës nga lagja Zabeli deri te shkolla Malush Ahmeti si dhe rrugë lidhëse-Punë shtesë |
| ,031 | 643-24-3877-5-2-5 | 45 | Ndertimi i kanalizimit fekal në BL Likovc-faza 3 (Abri Murgë)- Punë Shtesë |
| ,032 | 643-24-3641-1-3-6 | 01 | 023 - Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në qytetin e Skenderajt |
| ,033 | 643-24-3751-1-1-1 | 29 | Blerja e paisjeve motorike për mirëmbajtjen e qytetit të Skenderajt |
| ,034 | 643-24-6820-1-4-7 | 30 | Furnizim me tavolinë dhe karrige për zyre për nevojat e Drejtorisë së Urbanizmit |
| ,035 | 643-24-5578-2-2-1 | 93 | 040-Shërbime konsulente individuale në fushën inxhinierise -Teknologjisë në Komunën e Skenderajt |
| ,036 | 643-24-7413-5-5-8 | 30 | 046 - Blerja e dy kompjuterëve për nevojat e Drejtorisë së Urbanizmit - ritender |
| ,037 | 643-24-5043-5-2-5 | 45 | 034 - Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së –nr. prok. 2880 - Punë Shtesë |
| ,038 | 643-24-3856-5-2-1 | 45 | 027- Rikonstruimi i kulmeve të shkollave Qirez, Llaushë dhe Anton Çetta' në Komunën e Skenderajt |
| ,039 | 643-24-5596-2-3-6 | 93 | 035 - Kontrollimi teknik i automjeteve zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt - Ritender |
| ,040 | 643-24-4157-5-2-1 | 45 | 030 - Poligoni sportiv në shkollën Ahmet Delia në Skenderaj |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ,041 | 643-24-5518-1-2-1 | 30 | 039 - Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në shkolla |
| ,042 | 643-24-4331-5-3-6 | 50 | 033Renovimi rregullimi i parkut në Qëndren për punë Sociale |
| ,043 | 643-24-8474-1-4-7 | 30 | Furnizimi me Toner Ricoh Aficio MP T305 |
| ,044 | 643-24-3869-1-3-6 | 29 | 028-Blerja e një aporati fotografik dhe një objektivi per nevojat e zyres se informimit në Skenderaj |
| ,045 | 643-24-5383-5-1-1 | 45 | 037 - Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë, Qubrel, Kasterc, Vitak, Kllodernicë, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Klinë, Prekaz, Skenderaj |
| ,046 | 643-24-4294-5-2-1 | 45 | 032 - Renovimi i Ambulantës së Mjekësisë Familjare - Rezallë |
| ,047 | 643-24-7888-5-2-1 | 45 | 050-Asfaltimi i rrugës nga lagja Zabeli deri të shkolla Malush Ahmeti si dhe rrugët lidhëse -Faza 2 |
| ,048 | 643-24-7653-1-1-1 | 25 | 052-Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nëvojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioeve tjera që funksionojne në kuader të Komunës së Skenderajt |
| ,049 | 643-24-7756-2-3-6 | 92 | 053 - Organizimi i panairit për gratë ndërmarrëse si dhe akterëve tjerë të rëndësishëm |
| ,050 | 643-24-8365-2-3-6 | 93 | 041-Mirëmbajtja për sistemin e menaxhimit të radhës në objektin e komunës dhe QKMF-së |
| ,051 | 643-24-6587-5-2-1 | 45 | 044 - Ndërtimi i shëtitorës natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina |
| ,052 | 643-24-7520-5-2-1 | 45 | 051 - Ndërtimi i shtigjeve të çiklizmit në bashkësinë lokale të Qirezit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ,053 | 643-24-10006-1-4-7 | 31 | Furnizimi me Ventilator konvektor parapetit |
| ,054 | 643-24-8804-5-1-1 | 45 | 059 - Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i Ulët dhe në BL Runik, Prekaz, Turiçec, Likoc, Klinë e Epërme, Polac si dhe Qytet |
| ,055 | 643-24-6350-1-1-1 | 02 | 043 - Furnizim me lëndë djegëse (Dru dhe Pelet) dhe sharritja e tyre për nevojat e shkollave dhhe institucioneve tjera në kuadër të komunës së Skenderajt |
| ,056 | 643-24-8006-1-1-1 | 31 | 056 - Furnizimi dhe montimi i trafove elektrike - Ritender |
| ,057 | 643-24-10889-1-4-7 | 30 | 069 - Furnizim me inventar të zyrës së gjendjes civile në Runik |
| ,058 | 643-24-9516-2-3-6 | 93 | 062 - Mirëmbajtja e laurave rampave në autoparkun e Komunës dhe QKMF-së |
| ,059 | 643-24-6658-5-1-1 | 45 | 045 - Riparimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore në Komunën e Skenderajt |
| ,060 | 643-24-8964-5-2-1 | 45 | 061 - Vendosja e një Billbordi me pika turistike në Prekaz |
| ,061 | 643-24-12512-1-4-7 | 30 | 074 - Furnizim me inventar për zyre |
| ,062 | 643-24-8956-2-2-1 | 50 | 060-Mirëmbajtja e E-kioskes në Komunën e Skenderajt |
| ,063 | 643-24-7626-2-2-1 | 93 | 054 - Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve laboratorike në QKMF - Skenderaj |
| ,064 | 643-24-11154-1-3-6 | 30 | 070 -Furnizimi me paisje elektronike për zërim të seancave në Asamblenë Komunale -Skenderaj |

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë vitit 2024 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, Ligjin nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2024, Ligjin mbi Financat Lokale, udhëzimeve administrative nga Qeveria Republikës se Kosovës, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që dalin nga to dhe bazuar në planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2024

**1.Sektori për Buxhet dhe Financa**

- Janë hartuar Pasqyrat Financiare vjetore për vitin 2023 dhe dorëzuar me kohë në MFPT.

- Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2024,

-Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2023 dhe vitet tjera (344,349.32 € dhe janë destinuar sipas vendimeve të Kuvendit Komunal) në vitin 2024.

-Me kohë ka filluar implementimi i realizimit të shpenzimeve në sistemin Free-Balance .

-Janë bërë raporte financiare periodike për tërë vitin 2024 ( tri) dhe prezantuar e përkrahur në Kuvendin Komunal si dhe raporti përfundimtar për vitin 2024,

-Është përgatitur dhe aprovuar ne Kuvend Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

-Është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2025-2027 në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit aktiv në këtë proces të paraparë më Ligjin mbi MFPP.

-Barazimi i rregullt i shpenzimeve me MF dhe të hyrave në baza mujore,

- Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nëpër tremujor 2024, në tremujoret e ardhshëm për shpenzim brenda vitit 2024, shumica në tremujorin e fundit,

-Janë regjistruar në mënyrë të vazhdueshme asetet e komunës, është bërë verifikimi ( numërimi) i rregullt i tyre dhe në bashkëpunim me përgjegjësitë e programeve ( drejtorët e drejtorive ) janë formuar komisionet për regjistrimin e aseteve, si dhe komisionet për zhvlerësimin dhe hedhjen jashtë përdorimi të aseteve.

-Është punuar në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë tjera e në rend të parë me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit në përfshirjen e projekteve më me prioritet në buxhetin e vitit 2024 të komunës

**- të hyrat vetanake**

Të hyrat vetanake në periudhën janar - dhjetor 2024, si burim i financimit të buxhetit komunal janë realizuar sipas burimeve të lejuara me ligjin për financa të pushtetit lokal. Qëllimi kryesor ishte realizimi sipas planit për mbulimin e shpenzimeve të cilat rrjedhin nga planifikimi vjetor i buxhetit për këtë pjesë, miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Bazë për grumbullimin e të hyrave vetanake është Ligji i Financave të Pushtetit Lokal dhe rregullorja komunale mbi taksat, tarifat dhe gjobat.

Të hyrat vetanake të realizuara në periudhën janar – dhjetor 2024, krahasuar me

vitin paraprak 2023, dhe planifikimin buxhetor për të njëjtin sipas tabelës në vijim:

a. **Realizimi i të hyrave sipas programeve (drejtorive)**

Pasqyra e mëposhtme prezanton të hyrat e realizuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe planifikimin për vitin 2024.

| Nr. | Programet / Drejtoritë | Kodi | Plani buxhetor 2024 | Realizimi 2024 | Realizimi 2023 | % e realizimit | Struktu real. ne |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 1 | Administrata dhe personeli | 16323 | 72,590.00 | **64,202.04** | 57,936.85 | 88.44 | 3 |
| 2 | Inspektimi | 16645 | 9,620.00 | **8,505.00** | 10,079.30 | 88.41 | 0 |
| 3 | Buxhet e Financë | 17523 | 506,221.00 | **326,452.37** | 476,192.13 | 64.49 | 18 |
| 4 | Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi | 48023 | 34,600.00 | **28,545.00** | 24,600.00 | 82.50 | 1 |
| 5 | Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile | 18023 | 950.00 | **5,368.60** | 1,105.00 | 565.12 | 0 |
| 6 | Bujqësi dhe zhvillim rural | 47023 | 39,080.00 | **12,386.80** | 51,939.67 | 31.70 | 0 |
| 7 | Gjeodezia, Kadastri dhe Prona | 65315 | 156,930.00 | **331,503.26** | 274,143.42 | 211.24 | 18 |
| 8 | Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit | 66620 | 664,738.00 | **694,017.11** | 799,124.62 | 104.40 | 39 |
| 9 | Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale | 73032 | 26,300.00 | **16,761.00** | 14,634.00 | 63.73 | 0 |
| 11 | Shtëpia e shëndetit QKMF | 74400 | 31,150.00 | **36,823.00** | 31,544.00 | 118.21 | 2 |
| 12 | Kultura, Rinia e Sporti | 85023 | 4,180.00 | **522.00** | 664.00 | 12.49 | 0 |
| 13 | Arsimi – qerdhja e fëmijëve | 92650 | 73,030.00 | **52,829.00** | 44,669.00 | 72.34 | 3 |
| 14 | Të hyrat nga gjobat në trafik dhe te Gj. | | 264,882.00 | **184,781.50** | 149,061.00 | 69.76 | 10 |
| | Total | | **1,884,271.00** | **1,762,696.68** | **1,935,692.99** | **93.55** | **100** |




Nga tabela e mësipërme shihet realizimi i të hyrave vetanake (kolona 4) sipas drejtorive (bartëse të të hyrave) krahasuar më planin buxhetor 2023 (kolona 3), dhe realizimin e vitit paraprak 2023 (kolona 5). *Kolona 6* paraqet përqindjen e realizuar në raport me planin 2024, kolona 7 paraqet pjesëmarrjen në përqindje sipas drejtorive në realizimin e të hyrave totale.

Sa për analizë po përmendim: DBF-ja merr pjesë me 18.52 % në realizimin total të të hyrave , urbanizmi 39.37 %, gjobat e gjykatave 10.48 %, administrata e përgjithshme 3.64 %, gjeodezia 18.81 % etj.

Realizimi i planit buxhetor të të hyrave vetanake në këtë vit është 93.55 %. në raport me planin buxhetor.

Në detaje raportimi i të hyrave vetanake sipas llojit është përgatitur në raportin e buxhetit vjetor 2024.

b. **Punë tjera**;

- Është bërë me kohë barazimi mujor, dhe për periudhat e caktuara llogaritare në Departamentin e Thesarit në MF, janë bërë pjesërisht barazimet mujore me drejtoritë komunale që realizojnë të hyra, dhe të njëjtën kohë janë transferuar – alokuar gjithë të hyrat e realizuara sipas pozicioneve të planifikuara buxhetore me përjashtim të të hyrave që kanë tejkaluar planin 2024 dhe do të barten për shpenzim në vitin 2025.

**2. Sektori i Tatimit në Pronë**

Ky sektor gjatë vitit 2024 ka punuar dhe zbatuar dispozitat ligjore sa i përket fushëveprimtarisë së tatimit në pronë si:

-Menaxhimin e informatave për pronën

-Rexhistrimin dhe rianketimin e pronave

-Inkasimin e tatimit për pronën dhe

-Punët tjera administrative për pronën si ankesat e obliguesve etj.

Gjatë këtij viti stafi punues i këtij sektori është angazhuar në zbatimin e detyrave të planit për vitin 2023, duke filluar nga mbledhja e të dhënave (regjistrimin) e pronave të reja si dhe verifikimin e pronave të regjistruara më parë për ndryshimet eventuale në atë pronë, inkasimin e tatimit në pronë duke përdorur format ligjore për inkasim, azhurimin e informatave të ofruara per regjistrim në programin e tatimit në pronë si dhe punë tjera administrative sipas kërkesave të obliguesve tatimorë dhe detyrës zyrtare.

Realizimi i tatimit në pronë për vitin 2024 krahasuar me 2023

**Plani dhe realizimi i Tatimit në Pronë për vitin 2024**

| Nr. | Muaji | Planifikimi 2024 | Realizimi 2024 | Realizimi 2023 | % e realiz. me plan | Krahasin 2023/202 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 19,000.00 | 12,791.08 | 17,448.32 | 67.32 | -3 |
| 2 | Shkurt | 25,000.00 | 6,422.43 | 19,144.63 | 25.69 | -19 |
| 3 | Mars | 40,000.00 | 7,856.80 | 24,277.83 | 19.64 | -20 |
| 4 | Prill | 39,000.00 | 48,560.19 | 82,376.84 | 124.51 | -6 |
| 5 | Maj | 40,000.00 | 19,536.03 | 56,407.66 | 48.84 | -18 |
| 6 | Qershor | 35,000.00 | 6,593.38 | 25,775.38 | 18.84 | -29 |
| 7 | Korrik | 35,000.00 | 11,181.05 | 37,702.76 | 31.95 | -23 |
| 8 | Gusht | 45,000.00 | 25,049.41 | 54,396.27 | 55.67 | -11 |
| 9 | Shtator | 30,000.00 | 16,027.20 | 25,500.01 | 53.42 | -5 |
| 10 | Tetor | 20,000.00 | 27,015.27 | 13,498.63 | 135.08 | 5 |
| 11 | Nentor | 27,000.00 | 12,943.98 | 8,874.02 | 47.94 | 3 |
| 12 | Dhjetor | 30,000.00 | 23,484.55 | 9,483.57 | 78.28 | 5 |
| | **Totali** | **385,000.00** | **217,461.37** | **374,885.92** | 56.48 | -7 |

Sic shihet nga tabela krahasuese realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë në vitin 2024 ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2023 prej 72.39 %, ndërsa në raport me planin është realizuar 56.48 %. Kjo rënie është edhe si rezultat i faljes së borxhit deri në 100.00 € për të gjithë obliguesit e këtij tatimi sipas ligjit nr. 08/L-224, neni 11/B dhe të gjithë obligimet e kryera gjatë vitit 2023 deri në atë shumë janë llogaritur si parapagime.

**Aktivitetet e kryera në mënyrë tabelare:**

| | **A. Anketuesit e pronave (inspektimi i pronave)** | **Numri i aktiviteteve** |
|---|---|---|
| 1 | Anketimi i pronave të reja | 504 |

| | | |
|---|---|---|
| 2 | Ri-anketimi i pronave ekzistuese (modifikime) | 2180 |
| 3 | Rajonet e anketuara Skenderaj dhe fshatrat e Komunës | 26 |
| 4 | Pajisja me foto e objekteve | 950 |
| | | |
| | **B. Zyra për inkasim të tatimit në pronë** | **Numri i aktiviteteve** |
| 1 | Kontakte më tatimpagues | 266 |
| 2 | Përgatitja e njoftimeve përfundimtare | 402 |
| 3 | Shpërndarje e njoftimeve tek të gjithë obliguesit tatimorë | 246 |
| 4 | Marrëveshje më tatimpagues me z. e inkasimit | 37 |
| 5 | Vendime për ekzekutim të obligimeve | 26 |
| | | |
| | **C. Operatorët e futjes së të dhënave në sistem dhe zyrtari për ankesa** | **Numri i aktiviteteve** |
| 1 | Vërtetime, certifikata, fatura etj. | 2850 |
| 2 | Plotësimi me numra personal për çdo tatimpagues | 830 |
| 3 | Evidentimi i obliguesve të mëdhenj | 512 |
| 4 | Kontrata shitbl. nga dt.nga D.GJ.K . | 114 |
| 5 | Ankesa të pranuara dhe të verifikuara në teren | 49 |
| | | |

## DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

Drejtoria për Urbanizëm në bazë të statutit të Komunës dhe detyrave që i përkasin ka përfunduar për vitin 2024 këto detyra :

### PUNËT ADMINISTRATIVE

Punët administrative janë përfunduar me kohë në afatin e parapare ligjor pa vonesa dhe ngecje edhe pse natyra e lëndëve për drejtorinë tonë kërkon një kohë më të gjatë për zgjedhjen e lëndëve

si lëndët që kanë të bëjnë me leje ndërtimore, legalizimi, kërkesat e ndryshme të qytetarëve për projekte në infrastrukturë, pastaj vërtetime, certifikata etj.

- Përgatitja e projekt propozimeve
- Menaxhimi i projekteve
- Mbikëqyrja e projekteve
- Pranimet teknike

**REALIZIMI I PROJEKTEVE GJATË VITIT 2024**

- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe lumenjve në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiçec, Polac,- (ka përfunduar)
- Kanalizimi Vajnik – Kopiliq - (ka përfunduar)
- Kanalizimi Tushilë - (ka përfunduar)
- Kanalizimi në BL Qirez - (ka përfunduar)
- Punimi i kanalizimit në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiqec, Polac, Qirez, Runik, Likovc dhe Rezallë - (ka përfunduar)
- Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 – Prekaz - (vazhdim)
- Kanalizmimi Klinë - Kuqicë - (vazhdim)
- Ndërtimi i kanalizimit në BL-Likovc faza I - (ka përfunduar)
- Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së - (ka përfunduar)
- Rregullimi i shtratit të lumit Klinë e Ulët-Kuqicë dhe dy degëzimet e Llaushës - (vazhdim)
- Kyqja e kanalizimit lagjja Kodra-Polac - (ka përfunduar)
- Ndërtimi i urave ne fshatrat ; Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Tushilë, Tërrnac, Kllodernicë - (vazhdim)
- Kyqjet individuale në rrjetin e ujësjellësit në fshatin Burojë -në përfundim
- Rikonstruimi i kulmeve të shkollave Qirez, Llaushë, Anton Cetta –Skenderaj- (ka përfunduar)
- Rregullimi i subqendrës – Likoc - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës – Qirez - (vazhdim)
- Ndërtimi i qerdhës për fëmijë –vazhdimi i aneksit - (vazhdim)
- Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i Ulët dhe në BL Lokale; Runik, Prekaz, Turiqec, Likoc, Klinë e Epërme, Polac dhe në qytet – (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës nga lagjja Zabeli deri te shkolla Malush Ahmeti faza II - (vazhdim)
- Poligoni Sportiv në shkollën Ahmet Delija Skenderaj - (vazhdim)
- Ndërtimi i shtigjeve të ciklizmit në BL. Qirezit - (ka përfunduar)

- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Klinë, Polac, Makërmal, Ticë, Kopiliq i Epërm, Rakinicë (me grand të performancës) - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë, Qubrel, Kasterrc, Vitak, Kllodernicë, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Klinë, Prekaz - (vazhdim)
- Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen publike të UCK-së në Llaushë – (vazhdim)
- Ndërtimi i Muzeut dhe Bibliotekës së qytetit – (vazhdim)
- Ndërtimi i tregut të gjelbërt në Qytet – (vazhdim)
- Asfaltimi, riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet dhe BL Likoc, Turiqec, Runik, Qirez- (vazhdim)
- Ndërtimi i shëtitores natyrale përgjatë shtratit të lumit Klina - (vazhdim)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në Burojë - (ka përfunduar)
- Trotuaret dhe ndricimi në BL Likovc, Klinë e Epërme, Polac, Runik, Turiqec - (vazhdim)
- Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha - (vazhdim)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez - (vazhdim)
- Ndërtimi i Rrugës Kozhicë-Qyqavicë - (vazhdim)
- Ndërtimi i Rrugës Syriganë-Bjeshka e Syriganës - (vazhdim)
- Kanalizimi Syriganë, Banjë – Pemishtë - (vazhdim)
- Kanalizimi në fshatra të BL Turiqec-faza III - (ka përfunduar)
- Ndërtimi i kanalizimit në BL Likovc - faza III (Abri-Murgë) - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës –Runik - (vazhdim)
- Tribunat në stadiumin të qytetit - (vazhdim)
- Rregullimi i shtratit të lumit Klina Skenderaj-Tushilë - (ka përfunduar)

Të gjitha projektet e cekura më lartë janë menaxhuar dhe mbikëqyrur nga Drejtoria për Urbanizëm si ato të financuara nga Kuvendi Komunal ashtu edhe projektet të cilat kanë qenë të bashkëfinancuara.

**RAPORTI I LËNDËVE PËR VITIN 2024**

| Nr | Llojet e aplikimeve | Shuma € |
|---|---|---|
| 1 | Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit | 40 |
| 2 | Numri i lejeve mjedisore | 28 |
| 3 | Kërkesat për legalizim | 20 |
| 4 | Të tjera | 518 |
| | **Totali i të gjitha kërkesave** | **606** |

## TË HYRAT PËR LEJE NDËRTIMORE DHE MJEDISORE PËR VITIN 2024

| Nr | Llojet e aplikimeve | Shuma € |
|---|---|---|
| 1 | Të hyrat nga leje ndërtimore | 529,045.37 |
| 2 | Të hyrat nga leje mjedisore | 38,089.42 |
| 3 | Të hyrat nga legalizimi | 6,772.51 |
| | **Totali i të gjitha kërkesave** | **573,907.30** |

## DREJTORIA E INSPEKCIONIT

Drejtoria për Inspekcion për zbatimin e planit vjetor të punës për vitin 2024, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që ka për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve relevante, gjatë periudhës janar - dhjetor në të gjitha fushat që mbulon ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme më qëllim të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave që ka kjo drejtori.

Prioritetet kryesore të drejtorisë gjatë këtij viti ishin: mbrojtja e shëndetit të qytetarëve nga produktet jo të sigurta për konsum, mbrojtja nga praktikat mashtruese tregtare, qasja e papenguar në hapësira publike dhe ruajtja e tyre, transporti i sigurtë, rritja e sigurisë në trafik, mjedisi i pastër, mbrojtja nga degradimi urban, etj. Aktivitetet për secilën fushë që janë realizuar në kuadër të kësaj drejtorie janë përshkruar si në vijim.

**Gjithsej në vitin 2024 janë shqyrtuar 342 lëndë. 301 lëndë janë miratuar, 25 lëndë janë refuzuar, 6 të anuluara dhe 10 lëndë janë në proces.**

### FUSHA E TREGUT

Inspektorët e tregut kanë realizuar këto aktivitete:

- ☑ Janë inspektuar operatorët që merren me shitjen e produkteve ushqimore, furrat dhe shitësit e derivateve.
- ☑ Janë inspektuar 363 biznese, ndër të cilat janë dhënë 158 vërejtje me procesverbal për parregullsitë e hasura, para shqiptimit të masave ndëshkimore. Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 61 biznese të reja. Për plotësimin e kushteve minimale teknike janë shqyrtuar 33 kërkesa, 23 prej tyre janë pajisur me pëlqim, 10 kërkesa janë refuzuar
- ☑ Për produkte jo të sigurta, të dëmtuara, me afat të skadimit si dhe pa deklaracion, si dhe mashtrimi në peshë dhe mospërputhja çmim-arkë janë pranuar 15 ankesa nga konsumatorët të cilat janë shqyrtuar me korrektësi. Në 15 raste të ankesave kemi marrë masa ndëshkimore ku janë shqiptuar gjoba në vlerë: 1x200, 12 x 400€, 2 x 500€.

☑ Janë konfiskuar 908 produkte ushqimore jo të sigurta për konsum, të dëmtuara pa deklaracion dhe me afat të skaduar në peshën prej 112.0 kg si dhe në vlerë 913, 53 €. Këto produkte janë të klasifikuara si:

- Produkte të mishit: qofte 3 kg, suxhuk 6.789 kg, mish i tharë 8.800 kg. Gjithsej 18.800 kg në vlerë totale 118.79 €.
- Pije alkoolike dhe joalkoolike .
- Produkte ushqimore si keksë, ëmbëlsirë, hurma.
- Janë larguar nga tregu (shitja ) edhe 186 produkte jo ushqimore të dëmtuara dhe me afat të skaduar (kozmetikë, detergjent, shampona ).
- Janë konfiskuar 83 pako cigare në vlerë prej 205,80 euro pas ankesave të prindërve për shitje të cigareve të miturve afër shkollës, këto subjekte po ashtu nuk kanë prezantuar faturë. Këto produkte janë asgjësuar nga K.R.M. "Uniteti" Skenderaj.

☑ Në bashkëpunim me zyrtarët policorë janë mbyllur pesë bastore sportive të cilat operonin në mënyrë ilegale.

☑ Pas afateve të dhëna me procesverbale dhe vërejtjeve, ata të cilët nuk i kanë evituar ato, pas ankesave të pranuara nga konsumatorët dhe me inspektimeve të shitësve ambulativ, në bashkëpunim me zyrtarët policorë janë lëshuar 31 gjoba mandatore, në shumën prej 11,500.00 €.

☑ Kemi zbatuar vendimin nr. 1120/01 nga MTI për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës.

☑ Prioritet tjetër ka qenë dhe do të jetë luftimi i informalitetit (tregtia në të zezë), si dhe angazhimi në shërbim të qytetarëve edhe jashtë orarit zyrtar si vikendeve ashtu edhe gjatë festave. Kemi bërë thirrje për qytetarët që në rast të parregullsive të lajmërohen në zyrën e drejtorisë apo të kontaktojnë në nr. e telefonit 0800-1100 në kuadër të MTI-së në Prishtinë.

Janë shqiptuar këto gjoba për subjektet e më poshtme:
Për shitje të produkteve të duhanit personave nën moshën 18 vjeç janë shqiptuar tri gjoba.

1. Për mos respektim të orarit të punës – mos zbatim të Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës është shqiptuar një gjobë.

2. Për produkte ushqimore janë shqiptuar 6 gjoba, pas ankesave të qytetarëve për produkte me afat të skaduar dhe pa deklaracion.
3. Për mashtrime me çmime janë shqiptuar 12 gjoba, pas ankesave të qytetarëve për mospërputhje të çmimit raftë – arkë.
4. Për lokale që punojnë pa u regjistruar në ARBK, janë shqiptuar pese gjoba, pas ankesave të bizneseve që i kryejnë të gjitha obligimet.
5. Për shitës ambulativë janë shqiptuar katër gjoba si shkak i shitjes së produkteve jo të sigurta dhe pa fatura nga operatorët.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e tregut gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktiviteti i inspektorit* | *Nr. i aktiviteteve* | |
|---|---|---|
| *Vizita në biznese* | *363* | |
| *Vërejtje për biznese* | *158* | |
| *Biznese të reja (pas vërejtjeve)* | *61* | |
| *Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave* | *23 K. 19 A.* | |
| *Fletëparaqitje në gjykatë - Kërkesa të përmbaruesi* | *Nuk ka* | |
| *Gjoba të shqiptuara* | *31* | *11,500.00 €* |

**FUSHA E KOMUNIKACIONIT**

| 1 | **Aktiviteti i inspektorit** | |
|---|---|---|
| ***Procesverbale*** | | 27 |
| ***Lëndë të shqyrtuara –kërkesa të qytetarëve*** | | 15 |
| ***Gjoba*** | | 11 X 100 € |
| ***Filimi i procedurës përbarimor*** | | - |

- ☑ Gjatë kësaj periudhe raportuese janë hartuar 27 procesverbale, nga të cilat 15 kanë qenë kërkesa të shqyrtuara, 13 janë aprovuar si dhe 2 është refuzuar.
- ☑ Kemi punuar në transportin publik ku kemi bërë kontrolle operatorëve ekonomik të transportit publik ndaj të cilëve janë shqiptuar 11 gjoba:
  - ✓ 1 gjobë në vlerë 100 € për mosrespektim të rendit të udhëtimit
  - ✓ 5 gjoba nga 100 € ndaj kombi taxive të cilët janë hasur duke bartur udhëtar pa leje pune
  - ✓ 4 gjoba në vlerë 100 € ndaj auto taxi pa leje pune
  - ✓ 1 gjobë në vlerë 100 € për mos prezentim të certifikatës së verifikimit të taxi metrit.

  Të gjitha punët në transportin publik i kemi realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

Transporti publik mbulohet nga 11 operatorë transportues të licencuar në MI dhe të pajisur me rënde të udhëtimit nga Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe 11 auto taxi dhe 2 radio taxi me nga 5 automjete.

| **RËNDET E UDHËTIMIT NË TRANSPORT LOKAL** |
|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| Memi Bus Sh.P.K. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Sami Hoxha |
| Memi Travel Sh.P.K. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Kujtim Hoxha |
| N.T.Sh. Vellezërit Rrustemi | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Valon Rrustemi |
| N.T.P. Vllezërit Ferizi Sh.P.K. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Arsim Ferizi |
| N.T.Sh. Balli Trans | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Beçir Shala |
| Arta Tours Sh.P.K. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Mexhit Smajli |
| N.T.P. Fationi Bus | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Hamit Fetahu |
| Joni Travel Sh.P.K. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Avni Ademi |
| N.T. Zekaj Turs | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Faton Veliqi |
| Ismajli Ahmeti B.I. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Ismajl Ahmeti |
| Zeqa Tours Sh.P.K | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Zeqir Syla |

***Operatorët auto taxi dhe radio taxi të cilët kanë leje pune janë :***

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Data e lëshimit | Data e skadimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Gëzim Zena | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 2 | Ramiz Osmani | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 3 | Bekim Malaj | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 4 | Visar Behramaj | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 5 | Ismet Maloku | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 6 | Afrim Gjinofci | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 7 | Tafil Ahmeti | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 8 | Smajli Meha | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 9 | Blerim Sadiku | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 10 | Xhevdet Spahiu | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 11 | Sefedin Hasanaj | 14.05.2024 | 15.05.2029 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 12 | Isa Rushiti – Radio Taxi Blendi | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 13 | Endrit Lushtaku – Radio Taxi Diti | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| | | | |

Gjithashtu kemi punuar në sinjalizimin vertikal dhe horizontal ku kemi bër vendosjen e këtyre shenjave:

Situacioni I

| Nr. | PËRSHKRIMI | Njesia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | **Furnizimi me shenja të komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600** | cop | 20 |
| 2 | **Furnizimi me shtylla të zinguara Ø60 3m të gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50** | cop | 25 |
| 3 | **Tërheqja e zebrave njëkomponentëshe** | $m^2$ | 690.92 |
| 4 | **Vija horizontale 15 cm gjërësi, me ngjyrë njëkomponetëshe** | $m^2$ | 1965 |
| 5 | **Furnizimi me barriera gome** | $m^2$ | 9.75 |

Situacioni II

| Nr. | PËRSHKRIMI | Njesia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | **Pastrimi, piketimi dhe punët përgatitore për punimin e sinjalizimit horizontal** | $m^2$ | 2121 |
| 2 | **Furnizimi me shenja të komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600** | copë | 5 |
| 3 | **Furnizimi dhe vendosja e tabelave njoftuese nga alumini me trashësi 2mm dhe foli reflektuse 3M, me dimensione 100X60 cm** | copë | 3 |
| 4 | **Furnizimi me shtylla të zinguara Ø60 3m të gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50** | copë | 10 |
| 5 | **Tërheqja e zebrave njëkomponentëshe** | $m^2$ | 355 |
| 6 | **Vija horizontale 15 cm gjërsi, me ngjyrë njëkomponetëshe** | $m^2$ | 161 |
| 7 | **Pasqyrë rrugore Ø60 cm** | copë | 9 |

**Situacioni III**

| Nr. | PËRSHKRIMI | Njesia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | **Pastrimi, piketimi dhe punët përgatitore për punimin e sinjalizimit horizontal** | $m^2$ | 463 |
| 2 | **Punimi i shiritit akustik (vibrues) me material termoplastik me trashësi prej 1 cm** | $m^1$ | 446 |
| 3 | **Vija horizontale 15 cm gjërësi, me ngjyrë njëkomponetëshe** | $m^2$ | 301 |
| 4 | **Tërheqja e zebrave njëkomponentëshe** | $m^2$ | 110 |
| 5 | **Shlyerja e vijës ekzistuse** | $m^2$ | 52.5 |
| 6 | **Furnizimi me barriera gome** | $m^2$ | 3.25 |
| 7 | **Furnizimi me shenja të komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600 mm** | copë | 11 |
| 8 | **Furnizimi me shenja të komunikacionit nga alumini me foli reflektuese 3M me trashësi 2 mm me ram 600X300 mm** | copë | 2 |
| 9 | **Pasqyrë rrugore Ø60 cm** | copë | 2 |
| 10 | **Furnizimi me shtylla të zinguara Ø60 3m të gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50** | copë | 11 |

**Situacioni IV**

| Nr. | PËRSHKRIMI | Njesia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | **Vija horizontale 15 cm gjërësi, me ngjyrë njëkomponetëshe** | $m^2$ | 225 |
| 2 | **Tërheqja e zebrave njëkomponentëshe** | $m^2$ | 133 |
| 3 | **Furnizimi me shenja të komunikacionit nga alumini me foli reflektuese 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600 mm** | copë | 28 |
| 4 | **Furnizimi me tabela për emërtim të rrugëve 80X25, nga alumini me foli reflektuese 3M me trashësi 2mm** | copë | 9 |
| 5 | **Pasqyrë rrugore Ø60cm** | copë | 8 |
| 6 | **Furnizimi me shtylla të zinguara Ø60 3m të gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50** | copë | 40 |

Vendosjen e sinjalizimit horizontal – vijës gjatësore dhe vendkalimeve për këmbësor e kemi bër në rrugët e qytetit, punët në sinjalizimin horizontal janë kryer gjatë natës në mënyrë që mos të ketë pengesë nga automjetet. Po ashtu kemi bërë vendosjen e sinjalizimit vërtikal në rrugët e qytetit si dhe në rrugët kryesore të fshatrave.

Kemi hartuar një shkresë adresuar Ministrisë së Infrastruktures për rregullimin e sinjalistikës ndriçuese- semaforët në rr. Azem Bejta si dhe vendosjen e disa shiritave vibrues në këtë rrugë në mënyrë që nxënësit të cilët lëvizin në këtë pjesë të rrugës mos të rrezikohen nga ngasësit e automjeteve, nga ana e Ministrisë na është kthyer përgjigje në shkresë se do merren parasysh kërkesat tona, por punët nuk janë kryer.

***Kemi punuar në komisione për performancë komunale ku kemi bërë raporte në fushat e transportit publik, dhe hapësirat publike, komision për hartimin e draft planit për transportin publik, komision për rregulloren komunale për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve me automerimangë, si dhe kemi mbikëqyrur punët në asfaltimin e rrugëve në fshatrat Klinë e Poshtme, Klinë e Mesme, Klinë e Epërme, Makërmal dhe Rakinicë.***

Gjithashtu kemi punuar në lëmi të ndryshme së bashku me kolegë si dhe punë të tjera qe na janë urdhëruar nga drejtori, ku kemi punuar edhe pas orarit të punës, gjatë festave, si dhe ditëve të vikendit.

**FUSHA E MBROJTJES SË MJEDISIT**

Gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar aktivitete inspektuese, mbikëqyrëse dhe vlerësuese duke u bazuar në ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale për mbrojtjen e mjedisit siç janë:

Rëndësi të veçantë ka pasur monitorimi dhe inspektimi në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planit të punës si:

- ☑ Është bërë shqyrtimi i 45 kërkesave të qytetarëve dhe evidentimi i 18 rasteve gjatë inspektimeve në terren për problemet në rrjet të kanalizimit, bllokimit, rrjedhjes së ujërave të zeza, mungesës së rrjetit, dëmtimit të pusetave dhe shkaktimit të ndotjes nga këta faktorë. Rastet e evidentuara me procesverbale janë drejtuar në Drejtori për Shërbime Publike dhe në Drejtori të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, ku deri tani është intervenuar në 10 raste nga totali i raportuar nga Drejtoria e Inspekcionit.
- ☑ Evidentimi i 10 deponive ilegale të mbeturinave të cilat janë hasur gjatë inspektimeve në terren në zona urbane, në breze rrugore, parqe, rrjedha ujore të lumenjve dhe përroskave dhe në komplekse pyjore. Këto raste janë raportuar në Drejtorinë për Shërbime Publike, ku janë eliminuar tri deponi ilegale të mbeturinave prej numrit total të raportuara nga Drejtoria e Inspekcionit dhe janë vendosur tabela sinjalizuese. Në katër raste për hudhje të mbeturinave jashtë vendeve të caktuara personat përgjegjës janë gjobitur.

☑ Mbikëqyrja e 28 lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës të pranuara nga DUMA në vitin 2024, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i lejeve mjedisore të lëshuara në vitin paraprak.

☑ Mbikëqyrja e deponisë për materiale ndërtimore inerte në "Dell" të Qirezit dhe mbikëqyrja e menaxhimit të mbeturinave nga KRM 'UNITETI' dhe e aktiviteteve të pastrimit të NPL 'Eko Natyra' Sh. A.

☑ Aktivitete inspektuese për ruajtjen e mjediseve urbane dhe e peisazhit natyror brenda, në periferi e ndërmjet qendrave banuese, si rrugët trotuaret, mjediset e përbashkëta në lagjet e banimit, mjediset e gjelbëruara, parqet periferike.

☑ Janë lëshuar 23 urdhëresa për bizneset e evidentuara që nuk kanë qenë në shërbim që të lidhin kontratë tek operatori për menaxhim të mbeturinave.

- Bazuar në Ligjin nr. 08/l-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për Mbeturina dhe në Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në Skenderaj janë shqiptuar 29 gjoba: Për hudhje të mbeturinave komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale është shqiptuar një gjobë në vlerë 200 euro.
- Për hudhje të broshurave jashtë vendeve të përcaktuara nga komuna janë shqiptuar dy gjoba në vlerë 200 euro.
- Në vlerë 500 euro është shqiptuar një gjobë për hudhje të mbeturinave nga materialit inerte në brigje të lumit. Për hudhje të mbeturinave nga materialet ndërtimore jashtë vendeve të caktuara janë shqiptuara katër gjoba, tri gjoba në vlerë 200 euro dhe një gjobë në vlerë 90 euro. Në vlerë 70 euro është shqiptuar një gjobë për hudhje të mbeturinave inerte nga ballkoni i objektit.
- Për dëmtim të hapësirës publike, mos kthim në gjendje të mëparshme të dëmeve të shkaktuar është shqiptuar një gjobë në vlerë 500 euro si dhe një gjobë në vlerë 150 euro është shqiptuar për rrjedhje të ujërave fekale nga ferma e bagëtive në pronë private.
- Për dëmtim të drunjve dekorativë në hapësirë publike janë shqiptuar katër gjoba në vlerë 200 euro.
- Në vlerë 100 euro për kalim dhe parkim në hapësira të gjelbra publike janë shqiptuar 12 gjoba si dhe për djegie të mbeturinave të përziera është shqiptuar një gjobë në vlerë 100 euro.
- Per hudhje te mbeturinave te natyrave te ndryshme jashtë vendeve te caktuara eshte shqiptuar gjobe ne vlere 200 euro.

☑ Angazhimi në mbikëqyrjen e kontratës "Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit në Komunën e Skenderajt".

☑ Inspektimi i fabrikave në periferi të qytetit për të monitoruar ndikimin e tyre në mjedis si Weng Fat Poultry në Polac, Ferma e Pulave Drini në Marinë.

- ☑ Janë evidentuar pesë raste për dëmtim të drunjve dekorativë në rr. 17 Shkurti. Në njërin rast është bërë zëvendësimi i drurit të dëmtuar kurse në rastin tjetër për mospërfillje të urdhëresës për sanim të dëmit të shkaktuar, personi juridik që ka dëmtuar drunjtë dekorativë është gjobitur.
- ☑ Në mungesë të inspektorit të shërbimeve publike janë ndërmarrë veprime për mbrojtje të hapësirave publike si: aksioni për largimin e mallrave në bulevardin "Ilaz Kodra" dhe aksioni për pengimin e shitjes ambulative në trotuare, largimi i bllokuesve nga hapësirat publike të shndërruara në parkingje nga biznese të caktuara si dhe largimi i reklamave të vendosura pa leje.
- ☑ Janë shpërndarë urdhëresa për operatorët ekonomikë për t'u pajisur me leje per reklamat e vendosura para hapësirave të lokaleve ku zhvillojnë veprimtarinë dhe urdhëresa per t'i marrë në shfrytëzim hapësirat publike të cilat i shfrytëzojnë.
- ☑ Mbikëqyrja e rrjetit të ndriçimit publik, e kyçjeve në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit dhe shërbimeve tjera komunale. Janë evidentuar dy raste gjatë inspektimeve në terren për dëmtim të pusetave ku njëra prej tyre është rregulluar, një rast për probleme me rrjetin e ujësjellësit, tri raste për uzurpim të hapësirave publike ndër të cilat edhe mbyllja e një lokali si dhe nëntë raste për dëmtim të pronës publike dhe private. Këto raste janë shqyrtuar në bashkëpunim me organet kompetente që trajtojnë natyrat e këtyre parregullsive.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e mbrojtjes së mjedisit gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktivitetet* | *Nr. i aktiviteteve* |
|---|---|
| *Procesverbale* | 53 |
| *Kërkesa të qytetarëve/Lëndë* | 45 |
| *Njoftime zyrtare* | 3 |
| *Urdhëresa* | 80 |
| *Gjoba mandatore* | 29 |
| *Filimi i procedurës për kundërvajte – Masë përmbarimore* | 0 |

## FUSHA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

- ☑ Aksione për lirim të hapësirave publike si: aksioni për largimin e mallrave në bulevardin 'Ilaz Kodra', aksioni për pengimin e shitjes ambulative në trotuare.
- ☑ Monitorimi i parkingjeve në aspektin e sigurisë, largimi i bllokuesve nga hapësirat publike të shndërruara në parkingje nga biznese të caktuara si dhe largimi i reklamave të vendosura pa leje nga organet përkatese, lirimi i trotuareve, parkingjeve pas skadimit të kontratave të operatorëve.

- ☑ Mbikëqyrja e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të shesheve, rrugëve dhe trotuareve në zonën urbane dhe rurale të komunës.
- ☑ Inspektimin e hapësirave komunale duke parandaluar nga dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet e paautorizuara.
- ☑ Mbikëqyrja e rrjetit të ndriçimit publik, e kyçjeve në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit dhe shërbimeve tjera komunale.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e shërbimeve publike gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktivitetet* | *Nr. i aktiviteteve* |
|---|---|
| *Procesverbale* | 24 |
| *Kërkesa të qytetarëve/Lëndë* | 1 |
| *Njoftime zyrtare* | 0 |
| *Urdhëresa* | 16 |
| *Gjoba mandatore* | 1 |
| *Filimi i procedurës për kundërvajte – Masë përmbarimore* | 0 |

**FUSHA E NDËRTIMIT**

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë evidentuar:

- ☑ Rrënimi i objekteve të banimit – shtëpi në rr. Gjergj Fishta dhe rrënimi i dy objekteve në rr. 28 Nentori, Skenderaj.
- ☑ Largimi i dy objekteve montuese dhe i një shtëpie në rr. Ilaz Kodra.
    - ☑ Shqiptimi i një gjobe në vlerë 5000 euro ndaj operatorit "Andrra" SH.P.K Prishtinë.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e ndërtimit gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktiviteti i inspektorit* | *Objekte banimi + Afariste* | *Objekte banimi pa leje ndërtimi* | *Objekte me leje ndërtimi* | *Objekte garazh* | *Anekse* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Nr. i inspektimeve* | *204* | *4+4* | *26* | - | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | *(Tejkalim i lejes ndertimore)* | | | |
| ***Procescerbale, aktvendime, vendime për rrënim*** | *204* | *8* | - | | - |
| *Vërejtje/Urdhëresa* | *21* | - | - | - | - |
| *Kërkesa* | *165* | - | - | | - |
| ***Rrënimet*** | *6* | - | - | | - |

**ANGAZHIMI I INSPEKTORËVE JASHTË ORARIT TË RREGULLT TË PUNËS**

Inspektorët e profileve të ndryshme varësisht nga natyrat e aktiviteteve janë angazhuar edhe jashtë orarit zyrtar, gjatë vikendeve dhe festave zyrtare për:

- Shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve dhe ftesave të zyrtarëve policor për mbyllje të lokaleve që ushtrojnë veprimtari pa leje pune.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullore Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës.
- Mbikëqyrjen e sinjalizimit horizontal në rrugët e qytetit, konkretisht vijës gjatësore dhe vendkalimeve e këmbësoreve gjatë natës në mënyrë që të mos këtë pengesa nga automjetet.
- Kontrolla inspektuese në transportin publik.
- Intervenimi në rasteve të zjarrvënieve dhe hudhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara.
- Mbikëqyrjen e zhvillimit të aktiviteteve ndërtimore në zona ndërtuese.

## DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Duke u bazuar në objektivat dhe aktivitetet e Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2024 kemi ngritje të nivelit të shërbimeve efikase dhe cilësore ndaj qytetarëve si dhe përmirësimi i kushteve sociale për qytetarë në kuadër të sektorëve për shërbime publike dhe sektorit për emergjencë ne Drejtorinë për Shërbimeve Publike. Kjo drejtori ka si qëllimin arritjen e objektivave dhe planeve sipas aktiviteteve të shërbimeve publike, në tërë territorin e Komunës së Skenderajt. DSHP-ja ka të ndara shërbimet në dy njësi (sektorë) themelore, ku secila ka detyrat dhe përgjegjësit e saj.
Drejtoria e Shërbime Publike në bazë të punës për vitin 2024 edhe përkundër sfidave ka arritur me sukses përfundimin dhe realizimin e projekteve sipas planifikimeve buxhetore dhe kryerjen e detyrave tjera të punës të paraparë në kuadër të drejtorisë.
Drejtoria iu është përgjigjur kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë problemet e ndryshme për realizimin e të drejtave dhe ankesave në afatin e paraparë procedurale që përcaktojnë ligjet, rregulloret dhe statuti i komunës.

Në vazhdim janë të raportuar një mori aktivitetesh dhe punë të kryera gjatë vitit 2024.

- Mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike gjelbëruese, sheshit, rrugëve, trotuareve punët të cilat i ka kryer ndërmarrja komunale "NPL Eko Natyra .Sh.A" Skenderaj,
- Gjelbërimi i hapësirave publike, mbjelljen e luleve sezonale në qytet,
- Kemi bashkëpunuar me kompaninë regjionale te ujësjellësit "KRUM" që ofron shërbime rreth furnizimit me ujë, në sanime të defekteve në rrjetin e ujit, dhe rrjetit të kanalizimit,
- Larjen e rrugëve të qytetit dhe sheshit Adem Jashari,
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanaleve të ujërave të zeza dhe kanaleve të reshjeve atmosferike përmes kompanisë së kontraktuar.
- Mbikëqyrja e realizimit të shërbimeve që janë ofruar nga Bashkësia Islame në Skenderaj sipas memorandumit në mes Kryetarit të Komunës se Skenderajt.
- Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave vëzhguese në hapësirat publike,
- Mbikëqyrjen dhe kontrollin e shërbimeve të ofruara nga kompania kontraktuese për sigurimin fizik të objekteve të komunës së Skenderaj,
- Mirëmbajtën e rrjetit të ndriçimit publik duke intervenuar në sanimin e defekteve përmes kompanisë së kontraktuar nga Komuna e Skenderajt,
- Dhënia e vendimeve, pëlqimeve për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike,
- Mirëmbajtja e drunjve dekorativë në qytet,
- Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Skenderajt dhe eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale "Unitetit",
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror, dhe largimin e shembjeve të dheut, përmes kompanisë kontraktuese,
- Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Skenderajt, hartimi i planeve dhe strategjive komunale për menaxhimin e mbeturinave;
- Monitorimi hapësirave publike për menaxhimin e mbeturinave,
- Planifikimi dhe trajtimi i mbeturinave, organizimi dhe administrimi i mbeturinave
- Pjesëmarrja ne procesin e hartimit të draft plani ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në bashkëpunim me komunat e regjionit, si me komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt.
- Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave; Monitorimi i rregullores komunale për MM
- Planifikimin e hapësirave për vendosjen e kontejnerëve dhe përcaktimi i pikave statike për mbeturina dhe rregullimi i tyre
- Vendosjen e shenjave për kujdesin ndaj ambientit për mos hedhje të mbeturinave,
- Identifikimi i deponive ilegale ne territorin e komunës se Skenderaj për vitin 2024,
- Është bërë largimi i deponive ilegale të mbeturinave ne qytet dhe neper fshatrat e komunës së Skenderaj.

Në kuadër të aksionit për eliminimin e deponive ilegale në komunën e Skenderajt

| Përshkrimi | Sasia e deponive |
|---|---|
| Deponi të vogla | 27 |
| Deponi të mesme | 46 |
| Deponi të mëdha | 44 |
| Mako-deponi të mëdha e të përziera | 17 |
| **Totali:** | **136 Deponi** |

**Gjate vitit DSHP-ja ka pasur një numër të lartë të lëndëve të cilat janë shqyrtuar dhe proceduar në afatin ligjor:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Të Pranuara | **554** | **Lëndë** |
| 2. | Të Aprovuara | **456** | **Lëndë** |
| 3. | Të Refuzuara | **66** | **Lëndë** |
| 4. | Të Ceduara | **21** | **Lëndë** |
| 5. | Në proces | **0** | **Lëndë** |
| 6. | Pezulluara | **7** | **Lëndë** |
| 7. | Hedhura poshtë | **2** | **Lëndë** |
| 8. | Anuluara | **2** | **Lëndë** |

Të gjitha lëndët janë trajtuar dhe proceduar sipas afateve ligjore , dhe pas shqyrtimit të lëndëve janë dërguar në arkivin e komunës së Skenderajt.

Në kuadër të sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim janë kryer një sërë aktivitetesh dhe detyra të planifikuara dhe të paplanifikuara të rasteve emergjente të paraqitura gjatë vitit 2024.

-Është kryer Plani i Punës për vitin 2024.

-Janë dorëzuar në Komisionin Qeveritar në AME në Prishtinë të gjitha lëndët e vlerësuara nga dëmet e shkaktuara nga ERA që ka përfshirë komunën tonë me dt. 02.12.2023.

-E kemi përgatitur Planin e trajnimeve për vitin 2024 sipas kërkesës së AME-së dhe i kemi caktuar vijuesit nga SMSH dhe SHZSH që do të marrin pjesë sipas periudhës kohore.

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim si pjesë e DSHP-së ka qenë pjesëmarrëse e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga F.N.F.T. ku janë shqyrtuar kërkesa te qytetarëve për dëmet në bujqësi dhe për dëmet në ekonomi familjare.

Po ashtu ky sektor përmes operatorëve kontraktues ka qenë i angazhuar në hapjen e lumenjve dhe e gypave atmosferike gjatë rasteve emergjente të shkaktuara nga vërshimet.

Njësia Profesionale e Shërbimit të Zjarrfikësve – NJPSHZ, po ashtu ka qenë e angazhuar gjatë vitit 2024 në intervenime të ndryshme emergjente, të raportuara nga organet e rendit dhe qytetarët për rastet e shkaktuar nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, era dhe reshjet atmosferike.

Ky raport përmbledhës thekson aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë periudhës vjetore 2024

Tabela 1.

| Intervenimet 2024 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| NR | Emërimet | Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim - SMSH | Njësia Profesionale e Shërbimit të Zjarrfiksëve - NJPSHZ | GJITHSEJ |
| 1 | **Intervenimet në fatkeqësi natyrore** | 131 | | 131 |
| 2 | **Vërshimet, era, zjarri, breshëri** | 0,18,26,77, | | 121 |
| 3 | **Shërbimet teknike** | 10 | | 10 |
| 4 | **Shuarja e zjarreve** | | 253 | 253 |
| 5 | **Intervenimet teknike** | | 27 | 27 |
| | | **TOTALI :** | | **411** |

Tabela 2.

| Vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera-2024 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| NR | Emërimet | Nr. i rasteve | Shuma | GJITHSEJ |
| 1 | **Dëmet në Bujqësi** | 116 | 386,197.70 € | 386,197.70 € |
| 2 | **Dëmet në Ekonomi Familjare** | 9 | 81,197.70 € | 81,197.70 € |
| 3 | **Dëmet në Biznese** | 0 | 0 | 0 |
| 4 | **Infrastruktura** | 0 | 0 | 0 |
| 5 | **Institucione tjera** | 0 | 0 | 0 |
| | | **TOTALI :** | | **467,960,19 €** |

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë vitit 2024 janë kryer punët në harmoni, bazuar në planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal.

Aktivitetet e paraqitura si më poshtë pasqyrojnë aktivitetet kryesore për periudhën Janar-Dhjetor 2024

**-29 Janar** Përmes ëeb faqes së Komunës së Skenderajt është bërë Thirrja Publike për Projekte/Programe në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

**-17 Shkurt** Dita e Pavarësisë së Kosovës, Zbulimi i bustit të ish-sekretares amerikane Madeleine Albright, zbulimi i pllakës përkujtimore në shtëpinë ku u punuan armët gjatë luftës së fundit nga komandanti Malush Ahmeti, shfaqja e filmit dokumentar për luftëtarin e UÇK-së Bekim Birinxhiku në qendrën e kulturës "Hasan Prishtina".
**-28 Shkurti**, 26 vjetori i Betejës së Qirezit dhe Likoshanit.
**-4 Mars** Kemi qenë nikoqir i aktivitetit të parakalimit të 150 mjeteve "Off-Road" ku kanë marrë pjesë shumë autoklube të qyteteve të Kosovës, në itinerarin Skenderaj, Prekaz dhe më pas bjeshka e Moknës-Istog.

**-6 Mars** Zbulimi i busteve të heronjve **Sala e Hamit Jashari** në Prekaz, zbulim i pllakës përkujtimore në fshatin Tushilë tek shtëpia e cila shërbente si shtab gjatë luftës.
**-7 Mars** Përmbledhja e aktiviteteve zyrtare në shënim të Epopesë së UÇK-së, me pjesëmarrje të gjerë të jetës politike, kulturore dhe qytetarë të shumtë. Nga ora 18:00 u mbajt manifestimi i natës së zjarreve, ku paraprakisht u ndezën flakadanët të organizuar nga grupi rinor në Skenderaj, rit ky tradicional dhe më pas filloi koncerti me këngë e valle në sheshin "**Adem Jashari**". Performuan solistë të ndryshëm si dhe 2 ansamblet, Shota e Drenica.
**-12 Mars** janë publikuar përfituesit e projekteve të OJQ-ve dhe personave fizikë, ku kanë qenë gjithsej 23 përfitues

**-18 Mars** Akademi përkujtimore kushtuar luftëtarit Ragip Jashari në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" ku ishin 450 të ftuar.

**-24 Mars** është mbajtur maratona Vrapimi i Marsit- Izbica.

**-26 Mars** Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" është mbajtur konkrusi shkollor "Avancimet Kulturore Prof. Ajet Beqiri" në dy fusha kulturore atë të letërsisë me 140 punime si dhe artit figurativ. Aktiviteti ka karakter garues dhe për më të mirët u ndanë cmime sipas vlerësimit të jurisë.

**-26 Mars** Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" u shfaq filmi dokumentar kushtuar dëshmorit Mustafë Qorraj, ku kishim të pranishëm mbi 400 pjesëmarrës.

**-28 Mars** Në Izbicë më rastin e 25 vjetorit të Masakrës, janë bërë homazhe në Kompleksin Përkujtimor të varrezave të 147 civilëve shqiptar, pleq gra e fëmijë. Ku DKRS është përkujdesur për mbarëvajtjen e tubitmit përkujtimor.

**-29 Mars** Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" u bë promovimi i librit me poezi dhe titull "Ofshama e Izbicës" nga autori Albert Zekaj.

**-05 Prill** Tubim përkujtimi në nderim të të rënëve të Masakrës së Rezallës, në këtë aktivitet morën pjesë strukturat udhëheqëse qeverisëse të nivelit lokal dhe qendror.

**-18 Prill** Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" u shfaq filmi dokumentar "Gratë e Lirisë" me regjisore Sala Ahmeti Çitaku dhe Melihate Termkolli ku ishin të pranishëm rreth 300 pjesëmarrës.

**-30 Prill** Për nder të 24 vjetorit të rënies heroike të Komandantit Ilaz Kodra, është organizuar turneu memorial në Futboll të Vogël në palestrën e qytetit që mbanë emrin e Heroit Ilaz Kodra.

**-31 Maj** Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" është bërë promovimi i librit me poezi të autores së re Tuana Mëziu.

**-7 Qershor** Në vigjilje të ditës së çlirimit është mbajtur edicioni i 16-të i festivalit gjithëkombëtar në teatrot shkollore "Drenushat 2024" ku pjesëmarrëse janë SHFMU-të ku garuan gjithsej 100 nxënës dhe performuan para 400 shikuesve. Nga juria profesionale u vlerësuan më të mirët ku u ndanë edhe mirënjohje dhe çmime.

-10 Qershor Në sallën e Kuvendit Komunal në Skenderaj u bë promovimi i librit "Vuajtje për një fjalë të lirë", i autores Selvete Dervishi Nimani, mbështetur nga DKRS.

**-18 Qershor** Dita e Çlirimit të Skenderajt

Seanca Solemne e Kuvendit Komunal ku u shpall qytetar nderi z. Bardhyl Mehmeti.
Është mbajtur Akademi Përkujtimore me rastin e 18-të Qershorit si dita e Dëshmorëve dhe Martirëve të Komunës sonë me mbi 500 të ftuar. Është zbuluar shtatorja e heroit të vogël të Kosovës Leotrim Malush Ahmeti, me një ceremoni të organizuar nga DKRS ku morën pjesë mbi 2000 qytetarë. Ekspozitë me fotografi të luftës në Sheshin "Adem Jashari" të autorit Kadri Berisha. Dhe krejt në fund koncerti i organizuar për fëmijë në Sheshin "Adem Jashari" përgatitur nga Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me DKRS-në.

**-22 Qershor** Në kuadër të 25 vjetorit të Çlirimit të Skenderajt është mbajtur edhe turneu tashmë tradicional në Ping Pong kushtuar dr. Fatmir Fazliut.

**-Korrik-Gusht** Aktiviteti Muaji i Mërgatës
Gjatë këtyre 30 ditëve u mbajtën një mori aktivitetesh, ku çdo natë në Sheshin Adem Jashari janë mbajtur mbrëmje muzikore me solistë të ndryshëm për argëtimin e qytetarëve dhe mërgimtarëve tanë.
**-4 Gusht** Është organizuar "Street Ball" Skenderaj 2023.
**-10 Gusht** është organizuar Sofra Tradiconale Drenicase në Pllatonë e Qendrës së Kulturës të improvizuar si Odë si dhe janë servuar ushqime tradicionale, të pranishmit janë argëtuar nga një program i bukur i këngëve dhe valleve nga Ansambli Drenica dhe anekdota të ndryshme.

**- 30 Gusht** Në një ceremoni të organizuar në Runik është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit në mes Komunës sonë dhe Ministrisë së Kulturës për restaurimin dhe

konzervimin e asetit nën mbrojtje "Shtëpia e Kulturës" i cili gjendet në hapësirën e Subqendrës Runik.

- **Shtator** Vizita të shumta të shkollave të qytetit dhe qyteteve përreth në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" për t'i parë nga afër eksponatet në Muzeun e Qytetit tonë.

-**3 Tetor** Ora e Shkrimtarit – Bisedë Letrare, aktivitet ky i organizuar për nder të krijimtarisë letrare të ish ambasadorit Avni Spahiu. Aktiviteti u mbajt në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" dhe kishim të pranishëm mbi 200 qytetarë.

- **22 Nëntor** Në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" u mbajt shfaqja e titulluar "Familja Jashari, legjenda e kohës moderne", shfaqje nga nxënësit e Gjimnazit "Hivzi Nela" Shqipëri.

- **26-27-28 Nëntori**
Për nder të këtyre datave historike DKRS-ja organizon Festivalin Folklorik Gjithëkombëtar "Rapsodia Shqiptare" edicioni i 19-të. Festivali ka karakter garues dhe ikonë e festivalit është heroi Hamëz Jashari, garuese ishin mbi 40 grupe dhe solo këngëtarë dhe për tri netë radhazi salla kryesore e Qendrës së Kulturës ishte përplot shikues për t'i parë përformancat e garuesve. Me të mirët u shpërblyen nga juria profesionale ku çmimi kryesor është "Kulla e Jasharajve".
Poashtu është mbajtur "Vrapimi i Nëntorit" me gjatësinë prej 28 Kilometrash vrapim ku janë shpërblyer tri vendet e para në dy konkurrencat.

-**28 Nëntor** Zbulimi i Memorialit të Daljes së parë Publike të UÇK-së në fshatin Llaushë, për këtë aktivitet u përkujdes DKRS si dhe sipas të dhënave të Policisë pjesëmarrës ishin mbi 4700 persona.

- 11 Dhjetor u mbajt fesitvali "Poeti dhe Aktori" edicioni i dytë i cili u mbajt në Prekaz, në këtë festival morën pjesë 60 poet nga vendet e ndryshme të Evropës, i cili u organizua nga aktivistja dhe poetja Flora Brovina dhe profesoresha Drita Begolli, dhe bashkëorganizator i këtij festivali ishte edhe DKRS-ja.

## DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka zhvilluar aktivitete dhe detyra që dalin nga kompetencat që ka.
Në kuadër të këtyre detyrave dhe obligimeve ka kryer këto aktivitete: takime zyrtare me institucionet përkatëse siç është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit si dhe institucione të tjera.
Pjesë e punës ishin gjithashtu aktivitetet në teren brenda territorit të Komunës së Skenderajt, duke qenë kështu çdoherë pranë dhe në shërbim të qytetarëve si dhe aktivitete të tjera *ex officio*

që kanë qenë nevojë e Komunës.
Gjithashtu janë kryer të gjitha shërbimet që kanë qenë kërkesë e qytetarëve në zyrat tona siç janë pajisja me certifikata të pronësisë, kopje të planit dhe shërbimet e tjera të cilat i kemi përshkruar në hyrje të këtij raporti vjetor të punës.

D-Gj.K.P do të vazhdojë me aktivitetet e saj pa ndërprerë në kuadër të detyrave, që të jemi sa më efikas krahas kërkesave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve të komunës sonë, si dhe ndaj institucioneve tjera në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të përgjegjësive D-Gj.K.P në përgjithësi, e stafi i drejtorisë në veçanti, kanë qenë në nivel të detyrës, kështu duke shqyrtuar kërkesat e pastaj duke aprovuar apo refuzuar ato varësisht nga lloji i tyre, si dhe duke pritur në takim çdo palë për t'i ofruar sqarime të nevojshme juridike-pronësore, duke u munduar për gjetje të zgjidhjeve ligjore rreth problemeve pronësore.

Duhet përmendur fakti se drejtoria jonë i është përgjigjur çdoherë pozitivisht të gjitha kërkesave nga Drejtoria e Inspektoratit për të cilat ka ekzistuar dyshimi për uzurpim duke bërë kështu vërtetimin dhe identifikimin e gjendjes faktike si dhe kërkesave nga Drejtoria e Urbanizmit dhe drejtorive tjera duke bërë identifikimin dhe matjet gjeodezike për realizimin e projekteve komunale.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka zbatuar thuajse në plotni rekomandimet e nxjerrura nga raportet e monitorimit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, në sektorin e Gjeodezisë dhe Kadastrit.

Gjatë vitit 2024 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka shfrytëzuar të gjithë potencialin dhe kapacitetin e saj edhe përkundër numrit të vogël të punëtorëve, me qëllim për rritjen e performancës, përgjegjësisë në punë, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë në mënyrë që qytetarëve të Komunës së Skenderajt t'iu ofrohen shërbime sa më të mira pronësore-kadastrale.

**Lista e kërkesave për 2024**
Siç e kemi cekur edhe më lart në fillimin e vitit 2024, prioritet kryesor ka qenë shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe lëndëve të papërfunduara të vitit paraprak.

Bashkangjitur keni të dhënat për lëndët dhe kërkesat e realizuara nga Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër, për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024.

| **Kërkesat** | **Të pranuara** | **Të miratuara** | **Të refuzuara** | **Në proces** | **Gjithësejë** |
|---|---|---|---|---|---|
| Certifikata të Paluajtshmërisë | 2537 | 2537 | 0 | 0 | 2537 |
| Kopje të Planit | 1196 | 1196 | 0 | 0 | 1196 |
| Regjistrim, Modifikim, Bartje e Pronësisë apo Posedimit | 935 | 927 | 8 | 0 | 935 |
| Modifikim i parcelave | 164 | 163 | 1 | 0 | 164 |
| Bashkim i parcelave | 100 | 97 | 3 | 0 | 100 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Ndarje e parcelave | 244 | 238 | 6 | 0 | 244 |
| Regjistrim i ndërtesave | 26 | 26 | 0 | 0 | 26 |
| Regjistrim i pjesëve të ndërtesave | 36 | 34 | 2 | 0 | 36 |
| Regjistrim i qiramarrjes | 6 | 6 | 0 | 0 | 6 |
| Regjistrim i ngarkesës tatimore | 9 | 9 | 0 | 0 | 9 |
| Fshirje e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK-së | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| Krijim i bashkëpronësisë | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| Regjistrim i servitutit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Regjistrim i hapësirave të përbashkëta | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bashkim i personave të njejtë me ID të ndryshme në RDPP | 33 | 30 | 3 | 0 | 33 |
| Regjistrim, Modifikim dhe Fshirje e Hipotekave | 94 | 91 | 3 | 0 | 94 |
| Modifikim i të dhënave të personave në RDPP | 29 | 24 | 5 | 0 | 29 |
| Vërtetim që nuk posedon pronë | 687 | 687 | 0 | 0 | 687 |
| Kerkesa për shfrytëzim të pronës komunale (parkingje) | 15 | 65 | 0 | 15 | 80 |
| Kërkesa për heqje dorë nga pronësia | 6 | 6 | 0 | 0 | 6 |
| Të tjera | 8 | 0 | 0 | 8 | 8 |
| TOTAL | | | | | **6192** |

**Raporti financiar i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**
***Janar 2024 - Dhjetor 2024***

***Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër***

| | UNIREF | Dokumenti | Shuma |
|---|---|---|---|
| | SKG4L | Regjistrim, Modifikim, Bartje e Pronësisë apo Posedimit | *37,387.00 €* |
| | SKG4M | Taksë - Ndërrim i destinimit të tokës | *89,914.83 €* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | SKGFP | Taksë për fletë poseduese dhe kopje të planit | *12,623.00 €* |
| | SKG4U | Taksë administrative | *6243.00 €* |
| | SKG9D | Aktivitete në teren | *32,487.00 €* |
| | Totali i të hyrave në këtë sektor: ***178,654.83€*** | | |

***Sektorit i Pronës***

| | UNIREF | Dokumenti | Shuma |
|---|---|---|---|
| | SKG8E | Rente - Shfrytëzimi i pronës publike | *134,179.15 €* |
| | SKG8H | Qiraja nga objektet publike | *18,669.28 €* |
| | Totali i të hyrave në këtë sektor: ***152,848.43 €*** | | |

Totali të hyrave në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024 është: **331,503.26** EURO




Në përmbyllje të këtij raporti duhet theksuar se Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë gjatë vitit 2024 ka shënuar rritje të theksuar të aktiviteteve dhe punëve duke u angazhuar maksimalisht i tërë stafi i drejtorisë edhe në punë shtesë pas orarit zyrtar të punës kështu duke realizuar rritje rekorde të të hyrave financiare, të paraqitura edhe në tabelat e mësipërme.

## DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës njëvjeçare ka arritur me sukses t'i realizojë objektivat e planifikuara, të cilat kanë qenë të bazuara në planin e veprimit si dhe angazhime të shtuara në përmbushjen e kërkesave dhe obligimeve të paparashikuara.

Gjysmëvjetori i parë për vitin shkollor 2023-2024 ka mbaruar më 12 janar 2024. Drejtoria komunale e arsimit ka bërë analizën e suksesit të nxënësve për gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor.

## Sektori për arsim

### Angazhime në përgatitjet për fillimin e vitit të ri 2024-2025

Gjatë periudhës së pushimit dimëror janë bërë të gjitha përgatitjet higjieno-teknike për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024.

Gjysmëvjetori i dytë për vitin shkollor 2023-2024 ka filluar më 24 janar 2024. Me rastin e fillimit të gjysmëvjetorit të dytë, shkollat janë vizituar nga zyrtarët e DKA-së, për të parë së afërmi përgatitjet që janë bërë edhe nga shkollat për fillimin e kësaj periudhe.

Gjithashtu, shkollat e komunës sonë, janë vizituar vazhdimisht edhe nga Inspektorët e Arsimit në Mitrovicë, të cilët janë kujdesur për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor.

### Angazhime profesionale në zbatim të aktiviteteve të DKA

Ka vazhduar Vlerësimi i Performancës së shkollave nga Ekipi Vlerësues në nivel komunal, në kuadër të projektit KosEd, në shfmu "Shaban Jashari" Skenderaj, shfmu "Ahmet Delia" Skenderaj dhe "Abedin Rexha" në Turiçec.

Gjatë gjysmëvjetorit të dytë, zyrtarët e arsimit realizuan vizita nëpër të gjitha shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Qëllimi i vizitave ishte: mbarëvajtja e procesit mësimor, kontrollimi i ditarëve, i përgatitjeve me shkrim, i librave amë, i planeve të drejtorëve, pastërtisë etj.

Zyrtarët e arsimit vazhdimisht kanë mbajtur takime në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor si dhe kanë marrë pjesë në trajnime dhe punëtori të ndryshme.

Në disa shkolla, Policia e Kosovës – regjioni i Mitrovicës, kanë mbajtur ligjërata për nxënës me temën: “Siguria në shkolla dhe dukuritë negative që ndodhin në shkolla në ditët e sotme”. Gjithashtu, për sigurinë në shkolla kanë mbajtur sesione informuese, debate, tryeza diskutimi në shkolla edhe FSK-ja së bashku me pedagogët/psikologët e shkollave tona në kuadër të planprogrameve mësimore.

Drejtoria e arsimit në Skenderaj, së bashku me Fakultetin e Edukimit dhe TOKA kanë ripërtërirë marrëveshjen e bashkëpunimit për trajnimin e mësimdhënësve në metodologjinë “Të nxënit përmes përvojës”, projekt i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe i mbështetur nga Komuna Skenderaj. Mbi 40 mësimdhënës nga shkollat tona, në muajin prill kanë përfunduar me sukses trajnimin mbi metodologjinë e të “Nxënit përmes Përvojës”, të cilët u pajisen me certifikata të akredituara nga MAShTI.

Në muajin shkurt 2024, janë vaksinuar nxënësit e klasave të para, të gjashta dhe të dymbëdhjeta. Këtë vit, kanë përfituar nxënësit e klasave të gjashta, ku për herë të parë janë vaksinuar kundër virusit “humana papilloma virus”, i cili llogaritet të mbrojë mbi 95% të rasteve nga infeksionet dhe në këtë rast edhe nga kanceri i qafës së mitrës.

Është bërë renovimi i brendshëm i objektit të shfmu “Shotë Galica” në Runik, shfmu “Azem Bejta” në Prekaz të Epërm dhe shfmu “Kuvendi i Drenicës” në Abri të Poshtme.

Në muajin shkurt 2024, Shoqata Kosovare e Fizikës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit organizuan garën e fizikës për nxënësit e klasëve të IX-ta, X-ta, XI-ta dhe të XII-ta. Nxënësit fitues në këto gara marrin pjesë në garat në nivel shteti.

Janë intervistuar kandidatët e konkurseve për mësimdhënës, pedagogë, sekretarë dhe punëtorë teknikë.

Shkollat: “Hamëz Jashari” Skenderaj, “Ahmet Delia” Skenderaj, “Shaban Jashari” Skenderaj, “Shotë Galica”Runik, “Skender Skenderi”Vajnikë, “Kuvendi i Drenicës”Abri e Poshtme , “Elena

Gjika"Makërmal , "Abedin Rexha" Turiçec, "Idriz Barani"Klinë e Epërme, "Drenica" Polac, "Dëshmorët e Qyqavicës"Qirez dhe "Ismet Uka" Ticë janë pajisur me mjete mësimore në vlerë prej 136,900.00 € për lëndët: fizikë, kimi, biologji, gjeografi, informatikë dhe matematikë.

Në muajin shkurt u realizua me sukses procesi i vlerësimit të dosjeve të rreth 60 – mësimdhënësve, të ndarë tri grupe të ndryshme, lidhur me implementimin dhe zbatimin në praktikë të Kurrikulës së Re.

Me aktivitete të ndryshme dhe programe kulturo-artistike, në të gjitha shkollat e komunës sonë është kremtuar 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Në muajin shkurt është bërë përurimi i bibliotekës në Gjimnazin"Hamëz Jashari" në Skenderaj dhe është pasuruar me tituj të shumtë librash.
Me ministrin e Zhvillimit Ekonomik kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit për ndërtimin e çerdhes publike afër IAAP"Anton Çetta" në Skenderaj. Me këtë marrëveshje u vendos që ky objekt i çerdhes të riformatohet në tërësi, duke respektuar standardet e pranueshme të ndërtimit dhe çdo aspekt arkitektonik për të bërë një punë të mirë, nga e cila përfitues kryesor janë fëmijët e komunës sonë.

Në të gjitha shkollat e komunës së Skenderajt, janë mbajtur aktivitete në shumta për nder të Epopesë së Lavdishme të UÇK-së dhe 7 Marsit – Ditës së Mësuesit.

Gjithashtu, për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, Drejtoria e Arsimit ka organizuar një ceremoni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dhuratave për Veteranët e Arsimit, të cilët janë pensionuar gjatë vitit 2023-2024 dhe një takim të përbashkët me mësimdhënësit e të gjitha shkollave tona.

Në garën e XXV të fizikës 2024 në nivel shteti, të organizuar nga Shoqata Kosovare e Fizikës, morën pjesë nxënësit fitues të garës së fizikës në nivel komunal nga klasat e nënta, dhjeta, njëmbëdhjeta dhe dymbëdhjeta. Nxënësi i klasës së dhjetë, në Gjimnazin" Hamëz Jashari", Ariton Dragaj, zuri vendin e dytë në nivel shteti, ndërsa vendin e tretë në nivel shteti e zuri nxënësja e klasës së njëmbëdhjetë e po këtij gjimnazi, Jehona Nimanaj.

Në bashkëpunim me MAShTI dhe Federatën e Sportit shkollor të Republikës së Kosovës, për herë të dytë është realizuar programi njëjavor i skijimit "Drejt malit 2024". Pjesëmarrës ishin nxënësit

e klasave të shtata të shfmu “Ahmet Delia” Skenderaj (30 nxënës) dhe të shfmu “Fehmi Rama” në Likoc (30 nxënës).

Ka vazhduar vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara nga Ekipi Vlerësues në nivel komunal.

Janë kremtuar Ditët e Shkollave me aktivitete të ndryshme.

Kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi me përfaqësuesit e Shoqatës Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (ShPIK), për të organizuar “Javën e Orës së Kodimit” dhe zhvillimin e garave ndërkombëtare të Informatikës “Bebras Computing”, ku janë trajnuar mbi 500 mësimdhënës të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët në fushën e informatikës dhe kodimit.

Me aktivitete të ndryshme vetëdijesuese, rekreative dhe sportive është shënuar Dita Ndërkombëtare e Personave me Sindromin DOWN.

Me aktivitete të ndryshme, në të gjitha shkollave është shënuar 22 Marsit – Dita Botërore e Ujit, e cila ka për qëllim të tërheqë sa më shumë vëmendjen tonë për kujdesin ndaj ujit të pijshëm.

Me nxënësit e shkollave tona janë mbajtur garat sportive të organizuara nga Federata e Sportit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.

Në muajin mars 2024, Ekipi për Parandalimin e Braktisjes në nivel komunal ka vizituar dy raste të tentimit të braktisjes në fshatin Kopiliq i Poshtëm dhe një në Turiçec. Me këtë rast, ekipi ka arritur që dy prej tyre t’i kthej në shkollë, ndërsa për rastin e tretë do të vazhdojnë procedurat tutje.

Komuna e Skenderajt, në këtë vit shkollor, ka ndarë bursa për 110 studentë të komunës sonë në vlerë 500 euro dhe gjithashtu janë ndarë mjete edhe për transportin e nxënësve të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta si dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në vlerë total prej 40,000.00 Euro.
DKA së bashku me disa mërgimtarë investuan në shfmu ”Skënder Skënderi” në Vajnikë, duke i pajisur të gjitha klasat me projektorë, kabinetin e Informatikës me llap-top, bibliotekën e shkollës me tituj të rinj librash dhe oborri i kësaj shkolle është ndërtuar me trotuar me kocka betoni si dhe janë mbjellur drunj dekorues e lule.

Janë realizuar aktivitete të ndryshme me rastin e Ditës Botërore të Autizmit.

Profesorët e FEFS së bashku me ekipin hulumtues të projektit "Statusi i rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të arsimit fillor kanë realizuar matje dhe testime me nxënësit e klasave 1 dhe 9 të arsimit fillor.

Në muajin prill, mësimdhënës nga shkollat tona e përfunduan me sukses trajnimin mbi metodologjinë e të Nxënit përmes Përvojës, i cili është organizuar dhe realizuar në partneritet me Fakultetin e Edukimit, TOKA dhe Komuna Skenderaj si bashkëfinancuese.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, ka pasuruar bibliotekat e disa shkollave tona me tituj të rinj, ku janë pajisur 6 shkolla me nga 500 tituj të rinj.

23 Prilli – Dita Botërore e Librit është shënuar me aktivitete të ndryshme në shkollat tona. Disa shkolla mbajtën orë letrare e disa të tjera vizituan bashkë me nxënësit Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, me qëllim të ndërgjegjësimit të të rinjve mbi rëndësinë e pazëvendësueshme që ka libri në zhvillimet socio-kulturore të një shoqërie dhe të një vendi.

Vazhdimisht janë mbajtur ligjërata, takime dhe punëtori të ndryshme nga Qendra e Karrierës.

MAShTI në bashkëpunim me DKA – Skenderaj dhe gjimnazin "Hamëz Jashari" në Skenderaj, kanë organizuar "Java e informimit në gjimnaze për orientim në karrierë".

Është bërë planifikimi për regjistrimin e nxënësve në IP, klasë të para dhe të dhjeta.

Me 16 maj 2024, e përfunduan mësimin e rregullt nxënësit e klasave të dymbëdhjeta.

Gjatë muajit maj, janë mbajtur gara të ndryshme në nivel shkolle, komune dhe shteti. Në këto gara, nxënësit e komunës sonë treguan rezutate shumë të mira në lëndët: matematikë, gjuhë shqipe, gjuhë angleze, biologji dhe edukatë figurative. Këto gara janë mbajtur me nxënësit e klasave të katërta, të pesta, të teta dhe të njëmbëdhjeta të shkollave tona.

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Florida | Spahija | "Ahmet Delia" | Skenderaj | IV | I |
| 2 | Eduarta | Hasani | "Vëllezërit Frashëri" | Çubrel | IV | II |
| 3 | Gjin | Gjinovci | "Shaban Jashari" | Skenderaj | IV | III |

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Pikët |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rron | Rushiti | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | I |
| 2 | Lira | Thaçi | "Abedin Rexha" | Turiçec | V | II |
| 3 | Tuana | Bajra | "Ahmet Delia" | Skenderaj | V | II |
| 4 | Era | Lushtaku | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | III |

Sqarim: Vendin e dytë e ndajnë dy nxënëse, për shkak të rezultatit të barabartë në pikë.

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Suela | Dervishaj | "Shotë Galica" | Runik | VIII | I |
| 2 | Adnan | Ferizi | "Azem Bejta" | Prekaz i Epërm | VIII | II |
| 3 | Elsa | Qerimi | "Shaban Jashari" | Skenderaj | VIII | III |

Më të dalluarit nga klasat e njëmbëdhjeta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Jehona | Nimanaj | "Hamëz Jashari" | Skenderaj | XI | I |
| 2 | Artina | Hajdini | "Hamëz Jashari" | Skenderaj | XI | II |
| 3 | Dorentina | Selmanaj | IAAP "Anton Çetta" | Skenderaj | XI | III |

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e gjuhës angleze janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Osiana | Gjinovci | "Shaban Jashari" | Skenderaj | IV | I |
| 2 | Altin | Zabeli | "Ahmet Delia" | Skenderaj | IV | II |
| 3 | Rejana | Vojvoda | "Ahmet Delia" | Skenderaj | IV | III |

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e gjuhës angleze janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Erina | Lushtaku | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | I |
| 2 | Ari | Veliu | "Drenica" | Polac | V | I |
| 3 | Hyjnore | Syla | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | II |
| 4 | Omer | Vojvoda | "Ahmet Delia" | Skenderaj | V | II |
| 5 | Andora | Geci | "Halit Geci" | Llaushë | V | III |
| 6 | Jon | Mehmeti | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | III |
| 7 | Zoga | Murtezaj | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | III |

Sqarim: Vendin e dytë dhe tretë e ndajnë nxënësit, të cilët kanë arritur pikë të barabarta.

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e gjuhës angleze janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Alketa | Shaqiri | "Abedin Rexha" | Turiçec | VIII | I |
| 2 | Anela | Rexhepi | "Abedin Rexha" | Turiçec | VIII | II |
| 3 | Agnesa | Hajdini | "Abedin Rexha" | Turiçec | VIII | III |

Më të dalluarit nga klasat e njëmbëdhjeta në lëndën e gjuhës angleze janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Arzana | Lushtaku | "Hamëz Jashari" | Skenderaj | XI | I |
| 2 | Plarent | Gjinovci | "Hamëz Jashari" | Skenderaj | XI | II |
| 3 | Agnesa | Seferi | "Hamëz Jashari" | Skenderaj | XI | III |

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e matematikës janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kron | Zabeli | "Shaban Jashari" | Skenderaj | IV | I |
| 1 | Dajti | Goxhuli | "Ahmet Delia" | Skenderaj | IV | I |
| 2 | Andi | Hoti | "Drenica" | Polac | IV | II |
| 3 | Ledion | Ahmeti | "Ismet Uka" | Ticë | IV | III |

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e matematikës janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Amra | Dajaku | "Halit Geci" | Llaushë | V | I |
| 2 | Mirvjen | Mehmeti | "Shaban Jashari" | Skenderaj | V | II |
| 3 | Dëborë | Maliqi | "Ahmet Delia" | Skenderaj | V | III |

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e matematikës janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Altin | Geci | "Ahmet Delia" | Skenderaj | VIII | I |
